



RAPORT

“Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Korçë, Dibër dhe Sarandë.

Periudha e Monitorimit: Maj 2017-Shkurt 2018

ZBATIMI I LIGJIT “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE” (Ligj nr.9669, datë 18.12.2006), të ndryshuar

Përgatiti raportin: Av. Aurela Bozo



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Fuqizimi i qytetarëve lidhur me aksesin në drejtësi”, zbatuar nga Koalicioni “Drejtësi për të gjithë”, nëpërmjet organizatës anëtare AWEN-Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri. Tiranë, Mars 2018.

Falenderim

Një falenderim shkon për monitorueset e vendimeve gjyqësore, *Av. Adena Vangjeli*, nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Vlorë, *Av.Rezarta Agolli*, nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Durrës, *Zj.Ilda Boçi*, nga Shoqata “Jona”, Sarandë e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Sarandë, *juristen Sindi Kola*, nga Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Shkodër, *Zj.Esmeralda Beçaj*, nga Agritra-Vizion, Dibër e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Dibër, *Av. Soela Kurti*, nga Forumi i Gruas, Elbasan, e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Elbasan, *juristen Olgerta Demelli*, nga Shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec e cila monitoroi vendimet e GjRrGj Pogradec dhe *Zj. Krisula Koca*, e cila ka monitoruar vendimet e GjRrGj Korçë.

Ky falenderim shkon jo vetëm për monitorimin e kujdesshëm dhe plotësimin e skedës monitoruese por edhe për arritjet dhe problematikat që ndanë me autoren e raportit bazuar në mbështetjen që organizatat Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Shoqata “Jona”, Shoqata Gruaja tek Gruaja, Agritra-Vizion, Forumi i Gruas Elbasan dhe Shoqata “Unë Gruaja” ofrojnë për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Ju faleminderit!

TABELA E PËRMBAJTJES

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT	4
KREU I - PROFILI SOCIAL I VIKTIMËS DHE DHUNUESIT	4
1.1 Gjinia e palës paditëse	6
1.2 Profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare	7
1.3 Profili social i dhunuesit/es	7
1.4 Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare	10
1.5 Larmishmëria e marrëdhënieve të viktimës me dhunuesin	10
1.6 Format e dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare	12
1.7 Faktorë kontribues në lidhje me dhunën në familje	14
KREU II - EFEKTIVITETI I MBROJTJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE	15
2.1 Objekti i kërkesë padivë për lëshimin e umm/um	18
2.2 Disponimi i gjykatave të rretheve gjyqësore objekt monitorimi	19
2.3 Pushimi i gjykimit	19
2.4 Shkaqet e pushimit të gjykimit	20
2.5 Referime në konventën e këshillit të europës “për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” në arsyetimin e vendimit	21
2.6 Zbatimi i afateve procedurale për lëshimin e umm/um	22
2.7 Organet ku është denoncuar dhuna në familje	23
2.8 Shoqërimi i viktimës të dhunës në familje nga policia gjatë gjykimit	23
2.9 Padia publike	24
2.10 Ku janë bazuar gjykata e rretheve gjyqësore në dhënien e vendimit?	24
2.11 Larmishmëria e masave mbrojtëse: praktika pozitive	26
2.12 Roli i mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në familje	26
2.13 Përfaqësimi me avokat dhe mbështetja e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare	32
2.14 Referimi i vendimit të umm/um për ekzekutim	33
2.15 Kohëzgjatja e umm/um	34
2.16 Si është kryer denoncimi i dhunës në familje	35
2.17 Të dhëna mbi çështje të tjera që janë duke u ndjekur nga palët	36
KREU III - KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	36
Bibliografia	41

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT

Ky raport u mbështet në monitorimin e vendimeve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë, Durrës, Korçë, Pogradec, Elbasan, Dibër, Shkodër dhe Sarandë për lëshimin e urdhrave mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes për periudhën kohore Maj 2017-Shkurt 2018. Ai ka për qëllim të evidentojë, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore dhe praktikave gjyqësore të monitoruara nga avokatët e organizatave të shoqërisë civile, anëtare të Rrjetit AWEN, aksesin në gjykatë dhe në autoritetet e tjera të përcaktuara nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në këtë mënyrë, njëkohësisht nxjerrim në dukje, disa aspekte të rëndësishme të zbatimit të ligjit.

Në këto kushte, e konsideruam mjaft të dobishme të monitorojmë vendime të gjykatave të shkallës së parë, objekt monitorimi për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, me qëllim që të arrijmë në konkluzione, të cilat mund të shërbejnë për të evidentuar rolin e aktorëve përgjegjës në identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe parandalimin e saj, si dhe për të njohur dinamikën e zbatimit të ligjit kundër dhunës në familje nga aktorët përgjegjës. Ky monitorim hedh dritë edhe në një sërë aspektesh të tjera të rëndësishme, si fjala vjen, na lejon të kuptojmë se si ndihmon zbatimi i ligjit për mbrojtjen e familjarëve; të njohim format dhe mënyrat e ushtrimit të dhunës në familje dhe shkaqet e kësaj dhune; të njohim se si ka funksionuar rrjeti institucional kundër dhunës në familje, etj.

Monitorimi u organizua mbi vendimet gjyqësore për urdhërat e mbrojtjes dhe urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes të dhëna nga Gjykatat e rretheve gjyqësore, Vlorë, Durrës, Korçë, Pogradec, Elbasan, Dibër, Shkodër dhe Sarandë.

Por në të njëjtën kohë duke qenë se organizatat e shoqërisë civile që kanë kryer monitorimin ofrojnë edhe mbështetje ligjore falas për viktimat e dhunës në familje, ky aspekt ndihmoi që monitorimi të evidentojë probleme dhe të dalë me konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme.

Në këtë mënyrë, u monitoruan gjithsej 709 vendime gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, objekt monitorimi për çështjet me objekt lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Mbrojtjes. Janë monitoruar 89 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, 174 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, 51 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, 145 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, 28 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, 52 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, 89 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 81 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Monitorimet në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër, dhe Sarandë dhe Korçë janë kryer nga avokatë ose juristë të organizatave monitoruese, Forumi i Gruas Elbasan, Gruaja tek Gruaja Shkodër, Qendra Psiko Sociale “Vatra” Vlorë, Shoqata “Jona” në Sarandë, Shoqata e Grave me probleme sociale Durrës, “Argitra” në Peshkopi dhe Shoqata “Unë Gruaja” Pogradec. Ky element përbën një nga pikat e forta të monitorimit së pari sepse organizatat e shoqërisë civile, anëtare të rrjetit AWEN kanë eksperiencë të mëparshme në kryerjen e monitorimit të vendimeve gjyqësore me këtë objekt dhe së dyti sepse duke qenë avokatë ose juristë kanë të qartë procedurat dhe kjo garanton një monitorim më cilësor.

Monitorimi u mbështet në një skedë monitorimi e cila kombinon dy dimensione: social dhe tekniko-juridike. Kjo bëri të mundur që gjatë monitorimit, të nxjerrim një varg të dhënash e konkluzionesh për çështjet e problemet sociale që evidentohen nga vendimet e gjykatave, si dhe një sërë konstatimesh mbi mënyrën dhe teknikën e zbatimit të ligjit nga gjykatat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes urdhrave të mbrojtjes.

Skeda e monitorimit përfshin çështje të rëndësishme si: organet ku është referuar vendimi për zbatim, format e denoncimit drejtpërdrejt ose me telefon, “shkaqet” e dhunës, organet ku është denoncuar dhuna, shoqërimi i viktimës nga policia gjatë gjykimit, nëse denoncimi është kryer nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare apo nga komuniteti, ku është bazuar gjykata në lëshimin e vendimit të urdhrit të menjëhershëm të

mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes, në afatet procedurale të zbatuara për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, si dhe nëse subjektet që legjitimohen për paraqitjen e kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje e kanë ushtruar këtë të drejtë.

Bazuar në të dhënat që kanë rezultuar nga skedat monitoruese të plotësuara nga monitoruesit në rrethe, është përgatitur raporti monitorues.

Praktika e organizatave jo fitimprurëse që kryen monitorimin, në mbështetje të viktimave të dhunës në familje ka ndihmuar në identifikimin dhe analizën e problemeve në raport. Janë përgatitur raporte monitoruese për secilin rreth objekt monitorimi si edhe është përgatitur një raport i integruar.

Përgatitja e raporteve të monitorimit për çdo rreth është konsideruar si një mjet që mund të përdoret në nivel lokal nga organizatat jofitimprurëse dhe aktorët e tjerë lokalë për të lobuar për përmirësimin e zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar dhe rritjen e efektivitetit të zbatimit të tij në favor të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Raporti monitorues i integruar paraqet interes për të matur arritjet, për të identifikuar nevojat për përmirësime, për të analizuar tendencat, për t’ju referuar në mënyrë krahasuese gjetjeve të rretheve të ndryshme gjyqësore, për identifikimin e praktikave pozitive si dhe sfidave në zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, etj.

Metoda krahasimore, na ndihmoi për të arritur në disa konkluzione të rëndësishme. Kryerja e monitorimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ndihmon për rishikimin e vazhdueshëm të efektivitetit aktual të masave, vlerësimin progresiv dhe kryerjen e modifikimeve nëse janë të nevojshme. Krahasimi i të dhënave dhe evidentimi i disa të dhënave të reja, ndihmoi në nxjerrjen e konkluzioneve dhe sugjerimeve të dobishme.

Në përfundim, kryerja e monitorimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ndihmon për rishikimin e vazhdueshëm të efektivitetit të mjeteve ligjore që ai i ofron urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes, përmbushjes së detyrimeve ligjore nga aktorët përgjegjës në nivel qendror dhe vendor dhe përcaktimin e nevojave për ndërhyrje.

Raporti paraqet interes edhe në lidhje me matjen e punës së anëtarëve të Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në rrethet objekt monitorimi. Raporti me gjetjet që prezanton, përbën një mjet lobimi i cili mund të përdoret nga organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe aktorë të tjerë aktivë në këtë çështje.

Problematikat e evidentuara gjatë monitorimit përbëjnë një platformë pune edhe për organizatat monitoruese.

Kryerja e monitorimeve dhe studimeve mbi efektivitetin e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje përbën edhe një nga kërkesat që burojnë nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Një nga aktet më të rëndësishme të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, e cila kërkon nga shtetet palë studime dhe monitorime të vazhdueshme të legjislacionit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, është Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104/2012.


Kreu I - Profili social i viktimës dhe dhunuesit

Raporte dhe studime të ndryshme tregojnë për rritje të numrit të kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje. Kështu në vitin 2017, në nivel kombëtar janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes” 2593 raste. Gjatë vitit 2016 janë

plotësuar 2207 kërkesë-padi. Në 2017 ka rritje me 386 raste ose rreth 17.4% më shumë të trajtuara me kërkesë padi¹.

Vendimet e monitoruara

Janë monitoruar 89 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, 174 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, 51 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, 145 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, 28 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, 52 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, 89 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 81 vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.



1.1 GJINIA E PALËS PADITËSE

Gjykatat e rretheve gjyqësore	Numri i vendimeve gjyqësore	Pala paditëse/Grua	Pala paditëse/Burrë
Shkodër	89	81%	17.58%
Elbasan	174	85.06 %	14.94 %
Pogradec	51	74.07%	25.93%
Vlorë	145	88.28 %	11.72 %
Dibër	28	82%	17.86%
Sarandë	52	69.23	30.77
Durrës	89	73%	26.97%
Korçë	81	77.77%	22.22%

¹ MSHMS, RAPORT MASAT E MARRA NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE E DHUNËS NË FAMILJE 1 Janar – 31 Dhjetor 2017, (DRAFT)

Nga monitorimi kanë rezultuar të dhëna në lidhje me gjininë e palës paditëse. Kështu në 81 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 88.28 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 85.06 % të vendimeve të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 88.28% të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 82 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në 69.23 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në 73 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në 77.77 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pala e paditur është grua.

Në 14.94 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 25.93 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 30.77 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarande, në 17.58 % të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 26.97% të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në 17.86 % të vendimeve të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, në 11.72 % të vendimeve të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 22.22% të vendimeve të monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë gjinia e palës paditëse është burrë.

Këto të dhëna tregojnë sa e rëndësishme është që perspektiva gjinore të jetë pjesë e rëndësishme e kuptimit të konceptit dhunë në familje, si një nga format e dhunës me bazë gjinore.

Kjo gjetje mbështetet edhe nga të dhëna zyrtare referuar burimeve të tjera, si p.sh. të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sistemit REVALB dhe raporteve monitoruese të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kështu nga sistemi REVALB rezulton se për vitin 2017: Numri i rasteve të dhunës është: 758 raste; Numri total i dhunuesve: 1012 persona; Numri i personave të dhunuar : 1038 persona; Meshkuj: 180; Femra: 858²;

1.2 PROFILI SOCIAL I VIKTIMËS SË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt monitorimi kanë rezultuar disa gjetje paraprake në lidhje me profilin social të palëve ndërgjyqëse viktimës/dhunuesit, si në lidhje me aksesin e viktimave të dhunës në familje në sistem ashtu edhe efektivitetin e sistemit në mbështetje të viktimave.

Profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare rezulton të jetë kryesisht:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, profili social i një viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare, rezulton të jetë kryesisht e cila/i cili i është drejtuar gjykatës me një kërkesë për UMM ose UM është kryesisht një grua ose vajzë, me vendlindje dhe vendbanim në qytet, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, e martuar, me një ose dy fëmijë.

- grua
- me vendbanim në qytet
- me vendlindje në qytet
- e martuar
- me një ose dy fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike

² MSHMS, RAPORT MASAT E MARRA NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE E DHUNËS NË FAMILJE 1 Janar – 31 Dhjetor 2017, (DRAFT)

- me persona të tretë të dëmtuar fëmijët;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- me vendbanim dhe vendlindje në qytet
- e grupmoshës 31- 40 vjeç
- me shtetësi dhe kombësi shqiptare
- me arsim 8-9 vjeçar
- e/i papunë
- e martuar
- me 2 (dy) fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin/en
- e/i përballur me dhunë fizike dhe psikologjike;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- me banim në qytet
- me vendlindje në qytet
- i përket grupmoshës 31-40 vjeç
- me shtetësi dhe kombësi shqiptare
- me arsim 8-9 vjeçar
- e/i punësuar
- e/i martuar
- me dy fëmijë;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- e moshës 26-35 vjeç
- me vendbanim në qytet
- me vendlindje në qytet
- me arsim 8 -9 vjeçar
- me një fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- 36-45 vjeç³
- me vendbanim dhe vendlindje në qytet
- e martuar
- me dy fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë psikologjike;

³ Kjo e dhënë mund të shoqërohet me një risk të lartë gabimi sepse nga monitorimi i vendimeve të GjRrGjDurrës ka rezultuar një përqindje e lartë e rasteve pa të dhëna.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- e moshës 26-35 dhe 36-45 vjeç
- me vendbanim në qytet
- me vendlindje në qytet
- me arsim të mesëm
- e martuar
- me dy fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë fizike;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- 36-45 vjeç
- me vendbanim në qytet
- me vendlindje në qytet
- me arsim 8 vjeçar
- e martuar
- me dy fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike;

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, profili social i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare është:

- grua
- e moshës 26-35 vjeç
- me vendbanim në fshat
- me vendlindje në fshat
- me arsim 8 vjeçar
- e martuar
- me dy fëmijë
- në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin
- e përballur me dhunë fizike dhe psikologjike.

Gjetje të përbashkëta në lidhje me profilin social të viktimës.

Nga analiza e profileve sociale të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, në gjykatat e rretheve gjyqësore, objekt monitorimi dallojmë disa karakteristika të përbashkëta. Kështu në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore, në përqindjen më të lartë të rasteve viktime e dhunës në marrëdhëniet familjare është kryesisht një grua, e paarsimuar dhe e papunë, me vendlindje dhe vendbanim në qytet, me dy fëmijë, në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin. Viktimat e dhunës në familje janë përballur me forma të ndryshme të dhunës fizike, psikologjike dhe të kombinuar. Rezulton se fëmijët dhe pjestarë të tjerë të familjes janë persona të tretë të dëmtuar nga dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare.

1.3 PROFILI SOCIAL I DHUNUESIT/ES

Analiza dhe studimi i profilit social të dhunuesit që ushtron dhunë ndaj pjestarëve të familjes gjithashtu paraqet rëndësi. Për të ravijëzuar këtë profil, po i referohemi të dhënave që rezultojnë nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi.

Profili i dhunuesit/es nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Korçë rezulton: kryesisht burrë, i grupmoshës 36-45 vjeç, me vendlindje dhe vendbanim në qytet, i/e martuar, me arsim 8 vjeçar, me dy fëmijë.

Nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Sarandë, rezulton një profil i ngjashëm një burrë, 41-50 vjeç, me vendlindje dhe vendbanim në qytet, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 9 vjeçar, me dy fëmijë.

Nga monitorimi i vendimeve objekt monitorimi në GjRrGj Shkodër profili i dhunuesit rezulton kryesisht një burrë 36-45 vjeç, i martuar, me një fëmijë, me vendbanim dhe vendlindje në qytet.

Edhe nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Vlorë rezulton i njëjti profil i dhunuesit.

Nga monitorimi në GjRrGj Pogradec, i padituri rezulton të jëtë kryesisht një burrë, i grupmoshës 36-45 vjeç, me vendbanim dhe vendlindje në fshat, me arsim 8 vjeçar, i martuar, me 2 fëmijë.

Nga monitorimi në GjRrGj Dibër, rezulton se dhunuesi është kryesisht një burrë, i grupmoshave 26-35 vjeç dhe 36-45 vjeç, me vendbanim dhe vendlindje qytet, i paarsimuar, i martuar, me një fëmijë.

Nga monitorimi në GjRrGj Durrës, dhunuesi rezulton me këtë profil: kryesisht një burrë, i grupmoshës 36-45 vjeç, i martuar, me dy fëmijë⁴.

1.4 MBROJTJA E FËMIJËVE NGA DHUNA NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Nga monitorimi rezultojnë forma të ndryshme dhune ndaj fëmijëve. Disa nga këto forma janë dhunë fizike dhe psikologjike në prani të fëmijëve, viktimat dhe fëmijët kanë fjetur jashtë në disa raste për shkak të dhunës së ushtruar nga i padituri, dhunuesi përdor shprehjet “do t’ju djeg”, “do t’ju mbys”, dhunuesi nuk kontribuon për fëmijët dhe as për shkollimin e tyre si blerjen e librave, fletoreve⁵, goditje e vajzës me petrogazin e kafesë⁶, i padituri në prezencë të fëmijëve ka kryer veprime simuluese, sikur dëmton apo tenton të vrasë veten me sende mprehëse, situatë e cila ka shqetësuar dhe stresuar edhe fëmijët, etj.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare është shumë e rëndësishme për sigurinë e jetës së fëmijës së mitur dhe respektimin e parimit të interesit më të lartë të të miturit.

Edhe nga ky monitorim ka rezultuar se mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare kërkohet nga nënat përmes një kërkesë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhër mbrojtje të paraqitur nga nëna e fëmijëve, e cila kërkon mbrojtje për fëmijët në të njëjtën kërkesë përmes së cilës kërkon mbrojtje për vehte. Kështu në 16.55% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë është kërkuar vënia në mbrojtje edhe e fëmijëve të mitur, në 17.86% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Dibër, në 14.60 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës, në 33.33% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, në 25.45% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Sarandë, është kërkuar vënia në mbrojtje edhe e fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve përmes denoncimit të rasteve të dhunës ndaj tyre dhe urdhërave civilë të mbrojtjes, veçanërisht përmes forcimit të padisë publike të policisë dhe prokurorit, por edhe përfaqësimit nga qendra dhe shërbime, të afërm, persona ligjërisht përgjegjës (shkolla), etj., ka nevojë të forcohet. Gjykata mund të luajë një rol aktiv në këtë drejtim, përmes parashikimit kryesisht të masave mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Ky rol do të ishte në përputhje me rekomandimin e GREVIOs për Shqipërinë, i cili kërkon që autoritetet duhet të pyesin

⁴ Nuk po referojmë të dhënat në lidhje me vendbanimin dhe vendlindjen e të paditurit nga monitorimi në këtë gjykatë, sepse rezulton një përqindje e lartë pa të dhëna.

⁵ Vendimi i GjRrGj Shkodër.

⁶ Vendim i GjRrGj Shkodër.

kryesisht nëse, në rast të një kërkesë për urdhër mbrojtje të një viktime të dhunës në familje, përfshihen apo jo fëmijë, si dhe të shqyrtojnë nëse edhe për ta duhet të lëshohet një urdhër mbrojtje⁷.

Edhe miratimi i ligjit nr. 18/2017 “për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe akteve të tij nënligjore pritet të rrisin garancitë e mbrojtjes së fëmijëve.

Edhe pjestarët e tjerë të familjes kanë rezultuar persona të dëmtuar nga monitorimi. Kështu në 7 nga vendimet e monitoruara në GjRrGj Elbasan, rezultojnë persona të tretë të dëmtuar pjestarët e familjes.

1.5 LARMISHMËRIA E MARRËDHËNIEVE TË VIKTIMËS ME DHUNUESIN

Gjykatat e rretheve gjyqësore	Bashkësh ortë	Ish bashkësh ortë	Bashkëjet ues	Ish bashkëje tues	Prind/fëmijë	Fëmijë/prind	Dhëndër/vjehër Nuse/vjehër, (ish)	Kunetër/ku nata	Vjehër/nuse (ish)
Shkodër	50.5 6 %	3.37 %	5.62 %	-	13.48 %	-	4.50%	1.12%	-
Elbasan	47.7 0 %	10.3 4 %	5.75 %	0.57	10.92 %	2.3 0%	1.72%	5.75%	3.45%
Pogradec	48.1 0%	-	1.92 %	-	9.62 %	-	3.85%	-	1.92%
Vlorë	40.4 1%	14.3 8 %	3.42	6.16	10.27 %	2.0 5%	6.85%	4.11%	2.05%
Dibër	44.8 3%	-	-	3.45 %	13.79 %	-	10.34%	3.45%	-
Sarandë	21.15%	21.15	11.54 %	-	11.54%	5.77%	1.92%	3.85%	5.77%
Durrës	43.82%	11.24%	-	4.49 %	17.97%	1.12%	-	2.52%	4.49%
Korçë	49.38%	3.70%	2.47%	-	24.69%	-	4.94%	3.70%	-

Nga monitorimi rezultojnë të dhëna interesante në lidhje me marrëdhënien e viktimës me dhunuesin. Në përqindjen më të lartë të rasteve, marrëdhënia mes viktimës dhe dhunuesit është marrëdhënie bashkëshortore. Pavarësisht larmishmërisë së marrëdhënieve viktimë dhunues rezulton se kjo e dhënë mbetet qëndrueshmërisht më e larta.

E njëjta tendencë vazhdon të reflektohet edhe në marrëdhëniet ish bashkëshortore, duke reflektuar qartë se marrëdhëniet mes ish bashkëshortëve shoqërohen me mosmarrëveshje dhe konflikte të natyrave të ndryshme, që lidhen me çështje të takimit të fëmijëve, pagesës së detyrimit ushqimor, etj. Kështu, në një nga vendimet gjyqësore të monitoruara të GjRrGj Shkodër, ka rezultuar se ushtrimi i të drejtës së takimit të prindit me fëmijën e ka përballur paditësen me një situatë dhune.

Nga monitorimi ka rezultuar një larmishmëri në marrëdhëniet mes viktimës dhe dhunuesit. Pavarësisht se dhuna në familje është më shumë e pranishme në marrëdhëniet mes bashkëshortëve, ish bashkëshortëve, bashkëjetuesëve, ajo paraqitet si një fenomen që shoqëron gjithnjë e më shumë marrëdhëniet prind/fëmijë, nusë/vjehër dhe dhëndër/vjehër përfshirë ish nuse/vjehër dhe ish dhëndër/vjehër, kunetër/kunata, fëmijë/prind dhe vjehër/nuse përfshirë ish vjehër/ish nuse.

Në një nga vendimet e monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vlerësuar nga gjykata se dy ish bashkëshortët nuk përfshihen në termin “pjestarë të familjes”, në kuptim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Sipas gjyqtarit të çështjes, palët kanë cilësinë e ish bashkëshortëve por që nuk bashkëtojnë. Në këto kushte, gjykata nuk e ka legjitimuar paditësen dhe ka vendosur mospranimin e kërkesë padisë për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të

⁷ Raporti i GREVIOs për Shqipërinë, p.121.

Mbrojtjes. Mendojmë se, kjo është një praktikë jo në përputhje me frymën e ligjit kundër dhunës në familje, i cili synon të zgjerojë rrethin e pjesëtarëve të familjes sipas nenit 3 “Përkufizime”, pika 2, a.

Nga monitorimi ka rezultuar se subjekte që nuk përfshihen në konceptin “Pjesëtarë të familjes” kanë kërkuar lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Kështu në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Vlorë rezulton se viktima dhe dhunuesi kanë qenë të njohur, por nuk kanë bashkëjetuar me njeri - tjetrin. Të njohurit nuk legjitimohen të kërkojnë në gjykatat e rretheve gjyqësore lëshimin e UMM/UM sepse nuk përfshihen në konceptin pjesëtarë të familjes të parashikuar në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Kjo ka sjellë që gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të mos pranojë kërkesë padinë për lëshimin e urdhrave mbrojtës dhe marrjen e masave urgjente për mbrojtjen nga dhuna kur marrëdhëniet mes palëve janë të njohur, por që nuk kanë bashkëjetuar me njeri - tjetrin.

Në një nga vendimet e monitoruara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se palët kanë pasur miqësi familjare mes tyre për shumë vite, por nuk legjitimohen si subjekte që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Kjo e dhënë, të bën të reflektosh në dy drejtime kryesore:

Së pari, pavarësisht përpjekjeve dhe iniciativave të ndërmarra për njohjen e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ende është e nevojshme të punohet në këtë drejtim me qëllim njohjen e të drejtave që parashikon ky ligj dhe subjekteve që legjitimohen të kërkojnë mbrojtje.

Së dyti, kjo e dhënë shtron pyetjen a ka nevojë që legjislacioni shqiptar të rishikohet me qëllim marrjen e masave urgjente të mbrojtjes edhe për rastet e formave të tjera të dhunës, sidomos dhunës me bazë gjinore? A është dhe a duhet të jetë e drejtë e çdo individ, të gëzojë mbrojtje urgjente nga dhuna pavarësisht nëse është apo jo anëtar i familjes?

Së treti, a është e nevojshme që një ligj kuadër të përgatitet me qëllim adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe jo vetëm dhunës në familje?

Ky ka qenë edhe një nga rekomandimet e raportit të GREVIOs për Shqipërinë në Nëntor të vitit 2017, marrja e masave mbrojtëse për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore⁸.

1.6 FORMAT E DHUNËS SË USHTRUAR NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Gjykatat e rretheve gjyqësore	Dhunë fizike dhe psikologjike	Dhunë fizike	Dhunë psikologjike	Fizike, psikologjike, ekonomike	Dhunë psikologjike dhe seksuale	Dhunë psikologjike dhe ekonomike	Pa të dhëna
Shkodër	76.4%	3.37 %	14.61 %	1.12%			-
Elbasan	52.87%	4.60 %	41.38%			0.57%	0.57 %
Pogradec	31.37%	13.73	27.45%				27.45 %

⁸ Raporti i GREVIOs për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikutunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/p.4>

Vlorë	50.34%	%	34.48%		0.69%		14.48%
Dibër	28.57%	67.86	3.57%				-
Sarandë	30.77%	15.38%	53.85 %				-
Durrës	48.31 %		51.69				-
Korçë	14.81%	4.94%	18.52%				61.73%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 76.4% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 52.87 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 50.3 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 48.31% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në 31.37% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 30.77 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në 28.57 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe në 14.81 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë përballur me dhunë të kombinuar të formës fizike dhe psikologjike.

Konstatohet një prezencë në përqindje të lartë e formës psikologjike të dhunës në marrëdhëniet familjare. Kështu në 53.85% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në 51.69% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në 41.38% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 34.48% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në 27.45% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 18.52 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në 14.61% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në 3.57 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë përballur me dhunë psikologjike.

Në lidhje me dhunën fizike, ka rezultuar nga monitorimi se në 67.86% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, në 15.38% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në 13.73% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 4.94% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në 4.60 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në 3.37% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare është përballur me dhunë fizike.

Nga monitorimi kanë rezultuar edhe kombinime të formave të tjera të dhunës në familje si dhunë fizike, psikologjike dhe ekonomike në 1.12 % në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhunë psikologjike dhe seksuale në 0.69% të vendimeve të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dhunë psikologjike dhe ekonomike në 0.57% në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Format e dhunës në marrëdhëniet familjare të identifikuar nga monitorimi

Disa nga format e dhunës të identifikuar në vendimet objekt monitorimi janë:

“Nxjerrje me dhunë e të atit nga banesa”⁹, shprehje “Do të mbys”, “do të të vë bombën në lokal”, “do të të vras”, “rrahje e vajzës së mitur me rrip nga i ati”, “do të të zhduk nga ky vend”, “do të shikosh se çfarë do të bëj”¹⁰, “mori gërshërën të më vriste”¹¹, “më zuri për gryke dhe më goditi me shpulla”¹², “ka filluar të më godasë me grushte dhe shkelma, më ka ngjeshur pas murit duke më kapur me force nga flokët dhe duke më përplasur”¹³, “shpenzon të ardhurat në bare ku kalon mbrëmjet dhe neglizhon furnizimin e familjes me ushqim”¹⁴, “ka tentuar të më qëllojë me thikë”¹⁵, “paditësja në mënyrë të përsëritur i shkakton shqetësime me

⁹ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁰ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹¹ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹² Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹³ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁴ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁵ Vendim i GjRrGj Vlorë;

sjelljen e saj, duke mos ju bindur urdhrave të tij¹⁶, “sa dal nga porta e shtëpisë më thotë pse e kthen kokën andej¹⁷, “kërcënim me jetë nëse nuk tërheq kallzimin¹⁸, “më shan dhe fyen me fjalët më të ndyra si mua edhe familjarët e mi¹⁹, “kërcënoi se po të tentonin me familjen e paditëses t’i merrnin vajzën do t’i vriste me gjithë familjen” dhe se “do t’i lëshonte korentin në tualet për ta vvarë si aksident²⁰, “e shtruar në spital për shkak të dhunës së bashkëshortit²¹, “kërcënim me armën që posedon²², “kërcënime me vetëvrasje²³, “goditje me grushta në fytyrë për shkak se viktima dëshironte të shkonte tek prindërit²⁴.

Ky adresim me mjete ligjore i të gjitha formave të dhunës ndaj grave, është në përputhje me rekomandimin e GREVIOs për Shqipërinë nëpërmjet të cilit autoritetet shqiptare nxiten që të ecin përpara me masat e tyre për dhunën ndaj grave, duke garantuar që masat e marra të trajtojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore²⁵.

1.7 FAKTORË KONTRIBUES NË LIDHJE ME DHUNËN NË FAMILJE

Faktorë kontribues në lidhje me dhunën e ushtruar në marrëdhëniet familjare kanë rezultuar faktorët si më poshtë:

Faktorë	Denoncimi i dhunës dhe ndjekja penale	Grindje / mosm.	Alkoli	Varësi nga lëndë narkotike	Lojra fati	Divorce ose ndërprerje e bashkëjetesës	Natyra e dhunshme dhe çrreg. psik.	Xhelozia	Probleme pronësie	Probleme të shëndetit mendor
GjRrGj Shkodër		13	13		2	2	5		2	2
GjRrGj Elbasan		16	61	4				48		5
GjRrGj Pogradec		7	4		2		5	3	7	
GjRrGj Vlorë	5	3	24	3	1	4	24	6	18	2
GjRrGj Dibër		15						1	3	1
GjRrGj Sarandë									21	
GjRrGj Durrës		4	6	1		9		8	18	
GjRrGj Korçë		2	23		2	4		1		2
Totali	5	60	131	8	7	19	34	67	69	12

Faktorë të tjerë kontribues në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare janë:

¹⁶ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁷ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁸ Vendim i GjRrGj Vlorë;

¹⁹ Vendim i GjRrGj Vlorë;

²⁰ Vendim i GjRrGj Vlorë;

²¹ Vendim i GjRrGj Vlorë;

²² Vendim i GjRrGj Vlorë;

²³ Vendim i GjRrGj Vlorë;

²⁴ Vendim i GjRrGj Dibër;

²⁵ Raporti i GREVIOs për masat legjislatve dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. p.4. <https://rjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislatve-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>

Faktorë	Mosnjohja e atësisë së fëmijës	Papunësi dhe shkaqe ekonomike	Përndjekja	Largimi i bashkëshortes nga banesa dhe largësia nga njëri tjetri	Kërkesë për marrëdhënie intime nga të afërm të bashkëshortit	Gjendja e rënduar psikologjike e dhunuesit
GjRrGj Shkodër		7				
GjRrGj Elbasan		31				
GjRrGj Pogradec		10		1		
GjRrGj Vlorë	1	2	1	2	1	
GjRrGj Dibër						
GjRrGj Sarandë		8				1
GjRrGj Durrës		2				
GjRrGj Korçë		1				
Totali	1	61	1	3	1	1

Faktorë të tjerë kontribues në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare janë:

Faktorë	Mosmarrëveshje në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kujdestarinë e fëmijëve	Tradhëtia bashkëshortore	Shpenzim kohe në rrjete sociale	Kthimi nga emigracioni dhe jetesa e përbashkët në një banesë	Shfrytësimi i fëmijëve	Ndikimi i personave të tjerë
GjRrGj Shkodër	2	1			1	1
GjRrGj Elbasan	16	2				
GjRrGj Pogradec		2	2			
GjRrGj Vlorë						
GjRrGj Dibër		1				
GjRrGj Sarandë	3					
GjRrGj Durrës	2					
GjRrGj Korçë		1		1		
Totali	23	7	2	1	1	1

Faktorë kontribues që kanë kontribuar për akte dhune në marrëdhëniet familjare janë:

- Varësia nga alkoli (131)
- Mosmarrëveshje në lidhje me çështje pronësore (69)

- Xhelozia (67)
- Papunësi dhe probleme ekonomike (61)
- Grindje dhe mosmarrëveshje (60)
- Natyrë e dhunshme dhe çrregullime psikologjike (34)
- Mosmarrëveshje në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kujdestarinë e fëmijëve (23)
- Probleme që lidhen me zgjidhjen e martesës ose ndërprerjen e bashkëjetesës (19)
- Probleme të shëndetit mendor të dhunuesit (12)
- Varësi nga lëndë narkotike (8)
- Tradhëti bashkëshortore (7)
- Varësi nga lojërat e fatit (7)
- Denoncimi i dhunës në familje dhe ndjekja penale (5)

Alkoli është një faktor kontribues për dhunë në marrëdhëniet familjare.

Kështu, në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Vlorë, në çështjen me objekt lëshimin e UMM, në parashtrimet e saj paditësja tregon se abuzimi me alkolin ka sjellë shpenzimin e të ardhurave të fituara nga puna dhe mos përmbushjen e nevojave familjare. Alkoli ka përbërë një faktor kontribues si për ushtrimin e dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike.

Xhelozia

Në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, paditësja parashtron se bashkëshorti i saj është shumë xheloz dhe e pyet herë pas here se pse e kthen kokën andej, pse shikon ashtu, etj.

Zgjidhja e martesës ose ndërprerja e bashkëjetesës ka sjellë dhunë në marrëdhëniet bashkëshortore ose mes bashkëjetuesëve.

Ky faktor duhet të konsiderohet si një faktor i lartë rreziku nga punonjësit përgjegjës që punojnë me menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Kështu në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Vlorë, paditësja shprehet se pas zgjidhjes së martesës, ish bashkëshorti i saj e shqetëson pothuajse përditë, duke kërkuar me insistim që ata të rikthehen sërish sëbashku. Edhe ndërprerja e bashkëjetesës mund të shoqërohet me akte dhune për shkak të mospranimit të vendimit për t'i dhënë fund bashkëjetesës. Kështu, në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Vlorë, paditësja ka parashtruar se pas ndërprerjes së bashkëjetesës, i padituri nuk e ka lënë të qetë dhe e ka kërcënuar me shprehjen, “Nuk do të dalësh nga shtëpia nëqoftëse do të largohesh nga unë, do të largohesh vetëm e vdekur”.

Kjo është e lidhur ngushtë edhe me problemet që shoqërojnë zgjidhjen e martesës ose dhënien fund të bashkëjetesës. Kështu paditësja I.B. në një nga vendimet e monitorimit tregon se ajo dhe bashkëshorti i saj jetonin të veçuar nga njëri tjetri dhe se ajo është dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht nga bashkëshorti i saj, në kohën kur ajo ndodhej poshtë pallatit ku banon i padituri për të marrë djalin.

Gjykatat luajnë një rol të rëndësishëm me vendimet e qarta për parandalimin e dhunës në familje. Në rastet kur bashkëshortët kanë zgjidhur martesën, me vendimin e zgjidhjes së martesës gjykata ka rregulluar edhe pasojat si të drejtën e takimit, detyrimin ushqimor etj., çështje që shpesh krijojnë konflikte dhe mosmarrëveshje të ndryshme. Kështu në një nga vendimet e monitoruara në GjRrGj Vlorë rezulton se bashkëshortët kanë zgjidhur martesën, dhe gjykata ka vendosur t’ja lënë nënës fëmijën për rritje dhe edukim dhe babai të ketë të drejtën e takimit të fëmijës, në një orar të caktuar. Sipas këtij vendimi, fëmija gjatë orëve

të takimit me babanë duhet të jetë i shoqëruar nga nëna. Në kushtet e një kërkese nga paditësja për lëshimin e UMM, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lëshuar UMM duke vendosur ndër të tjera edhe: **Ndalimin e të paditurit të zhvillojë takimet me fëmijën të përcaktuara në vendimin për zgjidhjen e martesës, gjatë kohës që është në fuqi vendimi i lëshimit të UMM.** Sipas kësaj praktike, vendimi për zgjidhjen e martesës, në lidhje me pasojën e njëkohshme, të drejtën e takimit të fëmijëve do të fillojë të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM ose UM. Kjo shprehje e qartë nga ana e gjykatës është një praktikë që ndihmon në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe mos krijimin e konfuzionit në zbatimin e tyre, kur një vendim zgjidhje martese dhe një vendim urdhër mbrojtje janë marrë në të njëjtën kohë nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

Në rastin e bashkëjetesës, problemet që lidhen me fëmijët e lindur nga bashkëjetesa ose pasuria e krijuar gjatë saj mund të agravanojnë situatat e dhunës.

Kështu, në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Vlorë, ish bashkëjetuesi e ka kërcënuar paditësen me thikë në dorë duke i thënë se do ta vriste, se do t'i lëshonte korentin në banjë për ta vlarë si në një aksident, e ka urdhëruar të largohet nga shtëpia pa vajzën dhe e ka kërcënuar duke i thënë se po të tentonin me familjen e saj të merrnin vajzën, do të vriste atë dhe familjen e saj.

Takimet e ish bashkëjetuesëve me fëmijët që kanë lindur nga bashkëjetesa, mund të kthehen në mundësi të ushtrimit të dhunës mes ish bashkëjetuesëve dhe urdhrat e mbrojtjes mund të ndihmojnë në mbrojtjen e subjekteve nga dhuna dhe gëzimin e të drejtës së takimit të fëmijëve. Kështu në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, është marrë në UMM masa e lejit të paditurit të takojë fëmijët jashtë banesës së bashkëjetuesëve, në praninë e punonjësve të policisë ose të shërbimeve sociale.

Denoncimi i dhunës në familje dhe ndjekja penale e autorit

Në kushtet kur raportimi i dhunës në familje në polici kryhet në një përqindje shumë të lartë të rasteve nga viktimat e dhunës në familje, ato përballen shpesh me situatë të dhunshme pas vuajtjes së dënimit me burg nga dhunuesi.

Nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, ka rezultuar se paditësja ka parashtruar para gjykatës se ndihet e traumatizuar për shkak të dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar nga bashkëshorti i saj, i cili sapo kishte përfunduar vuajtjen e dënimit me burg për veprën penale “Dhunë në familje”;

Paditësja ka parashtruar para gjykatës se i padituri, vetëm pak ditë pasi ka përfunduar dënimin me burg është afruar në banesën e saj dhe e ka kërcënuar me jetë; i padituri është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 4 muaj burg për veprën penale “Dhunë në familje”, neni 130/a/1 i KP dhe pas daljes nga burgu, i padituri ka shkuar në banesën e paditëses dhe ka përdorur fjalë fyese si “K...ë”, më jep djalin, do të vras...”.

Raportimi i dhunës në familje dhe ndjekja penale e dhunuesit ka shkaktuar mosmarrëveshje dhe konflikte edhe midis viktimës së dhunës në familje dhe të afërmeve të dhunuesit. Kështu, në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, paditësja ka parashtruar se ndërkohë që ka qenë e shtruar në spital është “vizituar” nga vjehrra e saj e cila e ka kërcënuar duke i kërkuar të tërheqë denoncimin për të birin, bashkëshortin e paditëses, i cili ishte arrestuar dhe po ndiqej penalisht për çështjen e dhunës në familje.

Natyra e dhunshme e dhunuesit e shoqëruar me mentalitetin patriarkal

Në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, i padituri shprehet se, pas një debati si bashkëshortë e ka qëlluar me pëllëmbë bashkëshorten e tij dhe se në vlerësimin e tij, kjo sjellje është diçka e zakonshme dhe e lejueshme. Për dhunuesin, paraqitja e padisë në gjykatë nga ana e paditëses është fyese për të dhe sipas tij kjo nuk është mënyra e duhur për të mbajtur familjen dhe jetën bashkëshortore.

Probleme pronësore

Nga monitorimi kanë rezultuar vendime ku çështje pronësore, apo deklarime të banesave në proces legalizimi të pjesatërve të familjes kanë sjellë situata të shoqëruara me fjalë kërcënuese dhe sjellje të dhunshme në marrëdhëniet familjare.

KREU I II - EFEKTIVITETI I MBROJTJES PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

2.1 OBJEKTI I KËRKESË PADIVE PËR LËSHIMIN E UMM/UM

GjRrGj	UM	UMM	Vërtetim UMM	Masa shtesë mbi UMM	Vazhdim i efekteve të UMM	Ndryshim i UM
Shkodër	13.48%	71.91%	14.61%			
Elbasan	53.45%	31.03%	14.94%			0.57%
Pogradec	15.69%	31.37%	52.94%			
Vlorë	10.34%	88.28%	0.6%	0.6%		
Dibër	21.43%	78.57%				
Sarandë		100%				
Durrës		23.60%	73.03%		3.37%	
Korçë	16.05%	71.60%	12.35%			

Nga monitorimi rezulton se në 100% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 88.28% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, në 78.57% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, 71.91% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Shkodër, në 71.60% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë, në 31.03% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, në 23.60% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës dhe në 31.37% në GjRrGj Pogradec, paditësja/i ka kërkuar lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Në 53.45% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, në 21.43% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Dibër, në 16.05% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë, në 15.69% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, në 13.48% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër dhe në 10.34% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, paditësja/i ka kërkuar lëshimin e UM.

Është kërkuar vërtetimi i UMM, në 73.03% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës, në 52.94% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, në 14.94% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, në 14.61% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër, në 12.35% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë dhe në 0.6% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë.

Në 0.57% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan është kërkuar ndryshimi i UM.

Në 0.6% të rasteve në GjRrGj Vlorë, paditësja/i ka kërkuar masa shtesë mbi urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes me qëllim një mbrojtje më të mire, përmes masave urgjente të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “ Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Janë evidentuar raste kur paditësja/i kanë ngritur pretendime pronësore në gjykimin e çështjes me objekt lëshimin e UM. duke pretenduar se i padituri i ka prishur rubinetin e furnizimit me ujë të banesës gjatë kohës

që ajo ndodhej në punë. Në përfundim gjykata ka rrëzuar kërkesë padinë me arësytimin se pretendimet e paditëses rezultojnë të kenë karakter pronësor dhe nuk mund të zgjidhen nëpërmjet këtij gjykimi

2.2 DISPONIMI I GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE OBJEKT MONITORIMI

GjRrGj	Pranim i kërkesës Lëshim i UMM/UM	Pranim i pjeshtëm	Vendim pushim i	Kthim aktesh	Rrëzim	Refuzim	Mospranim	Pezulli	Ndërprerje e efekteve të UMM	Shtyrje e efekteve të UM	Pa të dhëna
Shkodër	51.68%		30.53%			6.74%	2.25%	2.25%			4.50%
Elbasan	40.23%		37.93%	0.57%	21.26%						
Pogradec	41.18%		43.14%		15.69%						
Vlorë	69.66	0.69	14.48	1.38	13.79						
Dibër	46.43%	3.57%	21.43%		3.57%	10.71%					14.29%
Sarandë	75%	1.92%	36.53 ²⁶ %		5.77%				3.85%		
Durrës	26.97%		59.55%		10.11%		1.12%		2.25%		
Korçë	24.69%		65.43%		7.41%	1.19%				1.19%	

Në lidhje me disponimin e gjykatës, nga monitorimi rezulton se në 75% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 69.6 % (rreth 70%) të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Vlorë, në 51.68% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Shkodër, në 46.43% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, në 41.18% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec, në 26.97% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, në 24.69% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë, gjykatat e rretheve gjyqësore kanë pranuar kërkesë paditë për lëshimin e UMM/UM.

Interes për t'u analizuar paraqesin vendimet me të cilat gjykatat e rretheve gjyqësore kanë vendosur rrëzimin e kërkesë padive për lëshimin e UMM/UM. Kështu në 21.26% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, në 15.69% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec, në 13.79% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, në 10.11% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, në 7.41% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë dhe në 5.77% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Sarandë, në 3.57% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesë padive për çështjet objekt monitorimi.

Në lidhje me shkaqet e rrëzimit apo refuzimit, rezulton se disa prej tyre janë:

- Vlerësimi i gjykatës se urdhri i mbrojtjes nuk ka qenë i nevojshëm, se rreziku për viktimën nuk provohej; se është provuar, se nuk ka pasur dhunë dhe mbrojtja është kërkuar për shkaqe të tjera;
- Mungesa e legjitimitetit procedural të palëve apo se palët ndërgjyqëse nuk janë subjekte të dhunës në familje sipas nenit 3 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

2.3 PUSHIMI I GJYKIMIT

Tabela në vijim tregon vendimet e pushimit²⁷ në % në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi.

²⁶ Në të dhënat e vendimeve të pushimit janë përfshirë edhe rastet kur gjykata ka lëshuar UMM (pra është edhe pranim i kërkesës) por gjykata ka pushuar vërtetimin e UMM.

GjRrGj	Vendime pushimi	Vendime të monitoruara
Shkodër	30.53%	89
Elbasan	37.93%	174
Pogradec	43.14%	51
Vlorë	14.48	145
Dibër	21.43%	28
Sarandë	36.53%	52
Durrës	59.55%	89
Korçë	65.43%	81

Është e vërtetë se ka një rënie të këtij numri në raport me 1 vit më parë në periudhën objekt monitorimi, por sidoqoftë, nr. i vendimeve të pushimit, mbetet sërish i lartë. Kështu nga monitorimi rezulton se vendimet e pushimit përbëjnë 65.43% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë, 59.55% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës, 43.14% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, 37.93% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, 36.53 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Sarandë, 30.53% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër dhe 14.48% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë.

Pushim i gjykimit në terma më të thjeshtë do të thotë që shqyrtimi i çështjes të mbetet në mes dhe nuk kemi ndonjë vendim përfundimtar të gjykatës, pra viktima të mos jetë e mbrojtur përmes masave urgjente që parashikon ligji por të përballet me një rrezik të lartë për sigurinë e jetës së saj.

2.4 SHKAQET E PUSHIMIT TË GJYKIMIT

GjRrGj	Vendime pushimi	Mospa qitje e paditëse s/it	Heqje dorë	Paraqitur në gjykatë tjetër e njëjta padi	Arrestimi i të paditurit	Mungesë provash	Mung lidhja e objekt të padisë me ligjin	Palët nuk përfshihen në n.3	UM i panevojshëm	Ekziston UM	Patë dhëna
Shkodër	30.53%	12.36%	13.48 %		1.12%	5.62%	1.12%	2.25%	1.12%		62.93%
Elbasan	37.93%	72.73%	25.76 %								1.52 %
Pogradec	43.14%	36.36%	63.63 %								
Vlorë	14.48	60%	35%	5%							
Dibër	21.43%	50%	16.67 %								33.33%
Sarandë	36.53%	63.16%	36.84 %								
Durrës	59.55%	26.97%	19.10 %			20.22%				2.25 %	31.46%
Korçë	65.43%	50%	48.15 %								1.85 %

²⁷ Pushimet e gjykimit në gjykatat e rretheve gjyqësore duhen lexuar në raport me numrin e vendimeve të monitoruara në secilën gjykatë objekt monitorimi.

Nga tabela rezulton se gjykata ka dhënë vendim pushimi për shkak të mosparaqitjes së paditëses/it në 72.73% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Elbasan, në 63.16% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 60% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Vlorë, në 50% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë, në 50% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, në 36.36% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec, në 26.97% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës dhe 12.36% të GjRrGj Shkodër.

Në 63.63% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec, në 48.15% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë, në 36.84% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 35% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Vlorë, në 25.76% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Elbasan, në 19.10% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, në 16.67% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër dhe në 13.48% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Shkodër, gjykatat kanë dhënë vendim pushimi për shkak se paditësja/i ka hequr dorë nga gjykimi i kërkesë padisë për çështjet objekt monitorimi.

Në 20.22% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për mungesë provash dhe në 2.25 % të vendimeve të monitoruara gjykata ka vendosur pushimin e çështjes sepse ekziston një UMM.

GjRrGj Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes në 5.62% të vendimeve të monitoruara për mungesë provash, në 2.25 % të vendimeve të monitoruara palët nuk përfshihen në nenin 3, në 1.12 % të vendimeve të monitoruara sepse mungon lidhja e objektit të padisë me ligjin, në 1.12% të vendimeve të monitoruara për shkak të arrestimit të të paditurit, në 1.12% të vendimeve të monitoruara për shkak se UM është i panevojshëm.

GjRrGj Vlorë në 5 % të vendimeve të monitoruara ka vendosur pushimin e çështjes sepse e njëjta kërkesë padi është paraqitur në gjykatë tjetër.

Në mënyrë të përmbledhur nga monitorimi i vendimeve të pushimit ka rezultuar se, shkaqet e vendimeve të pushimit të çështjeve janë:

- a) Heqje dorë nga gjykimi nga pala kërkuuese;
- b) Mosparaqitje e paditësit/es;
- c) UM është i panevojshëm, normalizimi i marrëdhënieve;
- d) E njëjta kërkesë padi është paraqitur në një gjykatë tjetër;
- e) I padituri është në ndjekje penale;
- f) Palët ndërgjyqëse nuk përfshihen në konceptin pjesëtarë të familjes, në nenin 3 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, paditësja ka kërkuar të heqë dorë nga padia e parashtruar në polici me arsyetimin se marrëdhëniet me të paditurin janë normalizuar dhe UMM do të ndikonte në përkeqësimin e marrëdhënieve mes bashkëjetuesëve.

Gjinia e palës paditëse në vendimet e pushimit.

Tërheq vëmendjen gjinia e palës paditëse në vendimet e pushimit. Kështu nga 55 vendime pushimi në GjRrGj Durrës, në 76.36 % pala paditëse është grua/vazjë dhe në 23.64% pala paditëse është një burrë. Nga 66 vendime pushimi në GjRrGj Elbasan, në 89.39% të vendimeve të pushimit pala paditëse është një grua dhe në 10.61 % të vendimeve të pushimit pala paditëse është një burrë. Nga 21 vendime pushimi në GjRrGj Vlorë në 85.71% të vendimeve të pushimit pala paditëse është një grua/vazjë dhe në 14.29% të vendimeve të pushimit pala paditëse është një burrë. Nga 6 vendime pushimi në GjRrGj Dibër në 83.33% të vendimeve të pushimit pala paditëse është grua/vazjë dhe në 16.67% të vendimeve të pushimit pala paditëse është burrë. Në GjRrGj Sarandë nga 9 vendime pushimi (7 vendime pushimi dhe 2 vendime të lëshimit të UMM dhe

vendim pushimi në vërtetimin e UMM) në 66/67% të vendimeve të pushimit pala paditëse është grua dhe në 33.33 % të vendimeve të pushimit pala paditëse është burrë. Nga 29 vendime pushimi në GjRrGj Shkodër, në 82.76% të vendimeve të pushimit pala paditëse është grua/vajzë dhe në 17.24% të tyre pala paditëse është burrë. Nga 22 vendime pushimi në GjRrGj Pogradec, në 77.27% të vendimeve të pushimit pala paditëse është grua, në 4.55 % të tyre pala paditëse është një grua dhe një burrë dhe në 18.18% të vendimeve të pushimit pala paditëse është një burrë. Nga 53 vendime pushimi në GjRrGj Korçë, në 83.02% të vendimeve të pushimit pala paditëse është grua dhe në 16.98% të vendimeve të pushimit pala paditëse është burrë.

Nga shpjegimet e palës paditëse në vendimet e pushimit, rezultojnë se paditësja tërhiqet nga gjykimi për shkak se: “nuk ndihet më e kërcënuar nga i padituri”, “palët i zgjidhën mosmarrëveshjet”, “zgjidhën çështjet me marrëveshje”.

Duhet të jemi shumë të vëmendshëm ndaj situatave të pajtimit, pasi shpesh ato janë situata jo të vërteta. Në disa raste vihet re se, si shkak për pushimin e gjykimit ka shërbyer edhe pajtimi i palëve. Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, nuk ka vendosur në asnjë rast përpjekjet për pajtim midis palëve, si mjet për gjyqtarin. Në përvojën e shteteve të ndryshme është kritikuar tendenca e pajtimit, pasi pajtimi mund ta detyrojë bashkëshorten t’i kthehet përsëri marrëdhënies abuzive dhe mund ta përballë me një rrezik edhe më të madh pas përdorimit të mjeteve ligjore.

Raportimet e përsëritura të dhunës në marrëdhëniet familjare janë një argument i qartë se shpesh këto situata pajtimi nuk janë të vërteta. Kështu në 29.21 % të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, rezultojnë se raportimi është kryer më shumë se një herë.

Tërheq vëmendjen nga monitorimi, se në disa raste kur kërkesë padia për lëshimin e UMM është paraqitur nga paditësja nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Vlorë, Gjykata nuk ka marrë parasysh heqjen dorë nga kërkesë padia me arsyetimin se kërkesë padia objekt gjykimi, është paraqitur në gjykatë nga Komisarati i Policisë Vlorë, për rrjedhojë tërheqja e viktimës nga padia nuk passjell mosshqyrtimin e saj²⁸.

2.5 Referime në Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”²⁹ në arsyetimin e vendimit

Nga monitorimi ka rezultuar një referim në rritje në aktet ndërkombëtare që adresojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave. Kështu rezultojnë referime në Konventën e Stambollit në Vendimin datë 28.01.2018, të GjRrGj Shkodër, Vendimin datë 6.10.2017, të GjRrGj Shkodër, Vendimin datë 18.12.2017, të GjRrGj Shkodër, Vendimin datë 17.10.2017, të GjRrGj Shkodër, Vendimi datë 6.5.2017, Vendimin datë 17.5.2017, të GjRrGj Shkodër, Vendimin datë 4.6.2017, Vendimi datë 5.7.2017, Vendim datë 5.7.2017, të GjRrGj Shkodër, etj. Kjo është një praktikë pozitive e përdorimit të standardeve ndërkombëtare si mjet për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

2.6 ZBATIMI I AFATEVE PROCEDURIALE PËR LËSHIMIN E UMM/UM

GjRrGj	Respektuar	Nuk janë respektuar	Pa të dhëna	Përfunduar afat i UMM/vërtetimi	Totali
Shkodër	89.89%	3.37%	6.74%		

²⁸ Vendimi i GjRrGjVlorë;

²⁹ Kjo Konventë është ratifikuar nga Shteti Shqiptar me ligjin nr.104/2012.

Elbasan	100%				
Pogradec	92.16%	3.92%	3.92%		
Vlorë	91.03%	6.21%	2.07%	0.69%	100
Dibër	67.86%		32.14%		
Sarandë	86.54%	5.77%	3.85%		
Durrës	96.63%	3.37%			
Korçë	97.53%		2.47%		

Kjo gjetje është në përputhje edhe me raportin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë³⁰, i cili ka theksuar se janë respektuar afatet ligjore rigorozisht prej të gjithë gjyqtarëve për periudhën e monitoruar, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës, Dibër, Elbasan, Pogradec, Sarandë dhe Korçë.

Në lidhje me sa më sipër, dëshirojmë të nënvizojmë se shpejtësia dhe respektimi i afateve, përbën një element thelbësor të gjykimit për urdhrat e mbrojtjes, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e kuptimit të tij. Veçanërisht shtyrja e seancës gjyqësore për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes është krejt e panevojshme, pasi gjyqtari mund të vendosë mbi bazën e rrëfimit të paditësit/es, meqenëse vërtetimi i urdhrin të mbrojtjes do të zhvillohet medoemos brenda 20 ditëve nga lëshimi i UMM-së. Gjithashtu, në të gjitha rastet e lëshimit të UM dhe UMM-së, ka vend për gjykime me një seancë të vetme dhe nuk ka kuptim gjykimi me shumë seanca, gjë që nuk do të realizonte edhe qëllimin e ligjit³¹.

2.7 Organet ku është denoncuar dhuna në familje

GjRrGj	Policia	Polici & Vatra/ Jona/ Forumi i Gruas Elbasan	Gjykatë	Polici dhe gjykatë	Avokat	Z.SH.Soci ale në bashki	Z.B.GJ & kundër dhunës	Strehëza e Emergjen cës	Pa të dhëna
Shkodër	71.91%		17.98%	1.12%					8.99%
Elbasan	97.70%	1.72%	0.57%						
Pogradec	53%		47%						
Vlorë	95.17%	2.07 %	1.38%						1.38%
Dibër									
Sarandë	92.31%	1.92%	1.92%		1.92%				1.92%
Durrës	100%								
Korçë	55.95%					1.19%	1.19%	1.19%	40.48 %

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UMM/UM në gjykatat e monitoruara, rezulton një rritje dhe larmishmëri e numrit të organeve ku viktimat kanë denoncuar dhunën në marrëdhëniet familjare. Kështu në 100 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës, në 97.70% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, në 95.17% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, në 92.31% të

³⁰ <http://www.kld.al/component/k2/raport-mbi-situaten-e-ceshtjeve-gjyqesore-per-dhunen-ne-familje> f.2

Ky raport mbështetet në të dhënat për dhunën në familje të marra nga gjykatat e rretheve gjyqësore për periudhën janar 2016-prill 2017.

³¹ www.qag-al.org

vendimeve të monitoruara në GjRrGj Sarandë, në 71.91% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër, në 55.95% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë dhe në 15.69% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë denoncuar dhunën në organin e policisë.

Nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Elbasan, rezulton se 97.70% e denoncimeve në polici janë si vijon: 57.47% në Komisarriatin e Policisë Elbasan, 5.75% në Komisarriatin e Policisë Cërrik, 10.92% në Komisarriatin e Policisë Gramsh, 2.87% në Komisarriatin e Policisë Peqin dhe 20.69% në Komisarriatin e Policisë Librazhd.

Rezultoni qartë se viktimat kanë besim tek organi i policisë dhe vazhdojnë të raportojnë dhunën e pësuar kryesisht në polici, si një organ përgjegjës që ofron siguri për jetën e tyre.

Në 84.31% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, në 17.98% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër, në 1.92% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Sarandë, në 1.38% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë dhe në 0.57% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Elbasan, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë denoncuar dhunën drejtëpërsëdrejti në gjykatë.

Raportimi i dhunës në familje në të njëjtën kohë edhe pranë Qendrës Psiko Sociale Vatra (2.07%), Shoqatës “Jona” (1.92%) dhe Forumit të Gruas Elbasan (1.72%) është një tregues shumë i rëndësishëm sepse i jep mundësi viktimës të marrë shërbime shumë të rëndësishme për të që në momentin e parë, si shërbime psikologjike, shërbim ligjor falas, etj.

Praktikë pozitive e denoncimit të dhunës në marrëdhëniet familjare

Konstatohet se ka një tendencë të raportimit të dhunës në marrëdhëniet familjare në Zyrën e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Korçë (1.19%), në Zyrën e Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në familje pranë Bashkisë Korçë (1.19%) dhe në Strehëzën Emergjente që menaxhohet nga Bashkia Korçë në 1.19%. Kjo tendencë është në përputhje me frymën e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të cilat parashikojnë që Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje drejtohet nga Kryetari i bashkive dhe strukturat e bashkive duke përfshirë koordinatoren vendore kundër dhunës në familje, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Mendojmë se kjo praktikë përbën një praktikë pozitive për t’u ndjekur dhe ndërtuar në bashki të ndryshme.

2.8 SHOQËRIMI I VIKTIMËS TË DHUNËS NË FAMILJE NGA POLICIA GJATË GJYKIMIT

Nga monitorimi rezultoni vetëm një rast në GjRrGj Sarandë që viktima është shoqëruar nga policia për në Gjykatë.

Nuk rezultoni të dhëna në lidhje me shoqërimin e viktimës së dhunës në familje nga policia për në seancën gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e UMM/UM në gjykatat e tjera objekt monitorimi.

Shoqërimi i viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare për në gjykatë, apo institucione të tjera, është i një rëndësie të veçantë për të garantuar sigurinë e viktimës. Kjo kërkon që organi i policisë të vlerësojë rrezikun e çdo rasti dhe kur e gjen të arësyeshme, të marrë këtë masë me qëllim garantimin e jetës së viktimës.

2.9 Padi Publike

Nuk rezultoni asnjë padi publike gjatë periudhës objekt monitorimi.

Kjo gjetje kërkon organizimin e trajnimeve “on job” për punonjësit e policisë me qëllim rritjen e nivelit të njohurive për konceptin e padisë publike, identifikimin e rasteve që kanë të nevojshme për shkak të rrezikut të lartë për jetën, të mbështeten nga organi i policisë nëpërmjet një padie publike si dhe të ndahen praktika të krijuara në komisariate të ndryshme të policisë në vend me qëllim ndarjen e përvojave më të mira.

Pranë gjykatave objekt monitorimi nuk ka rezultuar asnjë kërkesë padi për urdhër mbrojtjeje nga prokurori. Kjo lidhet me faktin se, denoncimet e dhunës adresohen fillimisht në polici, e cila paraqet kërkesën përpara gjykatës. Megjithatë, mbetet për t’u monitoruar gjatë hetimit të një veprë penale të dhunës të kryer brenda familjes, nëse lind nevoja që prokurori të kërkojë njëkohësisht edhe urdhrin e mbrojtjes, apo jo. Në këto raste, prokurori nuk duhet të hezitojë ta paraqesë kërkesën dhe gjykata nuk mund ta refuzojë atë, për faktin se çështja është duke u ndjekur penalisht (neni 17, pika 2 e ligjit)³².

Nga monitorimi nuk kanë rezultuar padi publike të paraqitura nga organi i policisë si padi publike. Nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, rezulton se megjithëse paditësja ka deklaruar në seancë gjyqësore normalizimin e marrëdhënieve me të paditurin dhe tërheqjen nga kërkesë padia, gjykata nuk e mori parasysh këtë kërkesë por vazhdoi gjykimin e çështjes, sepse kërkesë padia objekt gjykimi është paraqitur në gjykatë nga Komisarati i Policisë Vlorë. Por, po të shohim me kujdes palët ndërgjyqëse, pala paditëse është viktima e cila pretendon se është dhunuar nga bashkëshorti i saj. Gjyqtarja e çështjes ka arësytuar se tërheqja e viktimës nga padia nuk passjell mosshqyrtimin e saj. Padia publike në kuptimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, e ndryshuar, është padia që ka palë paditëse organin e policisë dhe palë të paditur dhunuesin. Padi me palë paditëse policinë ose prokurorinë nuk rezultojnë nga monitorimi.

Për këtë arsye edhe GREVIO ka nxitur autoritetet shqiptare të fuqizojnë ligj-zbatuesit për të qenë të aftë të përdorin, sipas rastit, të drejtat e tyre për të kërkuar lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin të mbrojtjes³³.

Megjithatë, kjo praktikë është në frymën e rekomandimit³⁴ të GREVIOs për Shqipërinë, sipas të cilit autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme, përfshirë ndryshimin e legjisllacionit përkatës, për të përjashtuar në mënyrë të qartë zbatimin e pajtimit gjatë veprimeve të procesit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

2.10 KU JANË BAZUAR GJYKATA E RRETHEVE GJYQËSORE NË DHËNIEN E VENDIMIT?

Vendimi i Gjykatës dhe mbështetja e gjyqtarit/es në bindjen e brendshme, fakte, prova, dëshmi.

Të dhëna në lidhje me mbështetjen e gjykatave në bindjen e brendshme, fakte, prova, dëshmi për dhënien e vendimit paraqiten në tabelën në vijim:

GjRrGj	Bindje e brendshme	Fakte prova dëshmit arë	Prova dhe bindje e brendshme	Deklarim e dhe bindje e brendshme	Prova, fakte, rrethana	Fakte, prova, dëshmitarë, rrethana fakti dhe bindje e brendshme	Dëshmi dhe fakte	Fakte dhe prova	Dëshmi
--------	--------------------	-------------------------	------------------------------	-----------------------------------	------------------------	---	------------------	-----------------	--------

³² http://www.qag-al.org/ËEB/deklarata/2010_raport%20_monitorimi.pdf

<http://www.qag-al.org/ËEB/deklarata/Raporti%20Monitorues%20i%20ligjit%209669.pdf>

³³Raporti i GREVIOs për masat legjisllative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjisllative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/> (p.43/a)

³⁴ Raporti i GREVIOs për masat legjisllative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjisllative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/> (p.42/a)

Shkodër	8.97%				51.68%	1.12%			
Elbasan									
Pogradec	7.84%	92.16%							
Vlorë	68.97 %	7.59 %							
Dibër	30.77%	53.85%							
Sarandë							38.64%	2.27 %	59.09%
Durrës	3.37%	48.31%		14.61%					
Korçë	1.23%	33.33%	1.23%						

Nga monitorimi ka rezultuar se në 68.97 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, në 30.77% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, në 8.97% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër, në 7.84 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, në 3.37% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Durrës, në 1.23% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë, gjykata ka vendosur në lidhje me lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet, siç parashikon neni 15, “Provat në procesin gjyqësor”, pika 3 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Por nga monitorimi kanë rezultuar raste kur gjqtarët e çështjeve kanë vendosur rrëzimin e kërkesë padisë për shkak të mungesës së provave. Kështu në një nga vendimet objekt monitorimit të GjRrGj Durrës, gjyqtarja e çështjes arësyetonte se paditësja kërkonte lëshimin e Urdhrin të Mbrojtjes për të, me afat një vit, duke pretenduar se ka patur shqetësime me telefon, duke mos i paraqitur asnjë provë trupit gjykues që të vërtetojë këtë fakt

2.11 LARMISHMËRIA E MASAVE MBROJTËSE: PRAKTIKA POZITIVE

Nga monitorimi ka rezultuar një larmishmëri e masave mbrojtëse, duke përfshirë kombinime të të gjitha masave mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Gjykata ka konsideruar kërkesë padinë si një kërkesë padi me objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe jo thjesht marrjen e masave të caktuara mbrojtëse. Janë evidentuar vendime me masa që gjykata ka çmuar se rrisin mbrojtjen e viktimës. Kështu, në disa vendime objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë gjykata ka vendosur urdhërimin e një punonjësi të policisë të shoqërojë paditësen deri në vendin e banimit dhe të punës dhe të mbikqyrë paditësen.

Ky qëndrim i kujdesshëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është në përputhje me rekomandimin³⁵ e GREVIOs për autoritetet shqiptare, të cilat pa cënuar nevojën për siguri të menjëhershme të viktimave, rekomandohet të integrojnë, në procedurën e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin të mbrojtjes, vlerësimin e rrezikut.

Një kombinim të masave mbrojtëse konstatohet edhe në vendimet e monitoruara të GjRrGj Shkodër. Për të siguruar jetën e viktimave të dhunës në familje, gjykata ka urdhëruar Komisaratin e Policisë të mbajë në mbikqyrje të pandërprerë të padiurin duke e urdhëruar të paditurin të paraqitet çdo ditë pranë Komisaratin të Policisë. Këtë masë gjykata e ka kombinuar me detyrimin e dhunuesit që të ndjekë programin e rehabilitimit

³⁵ Raporti i GREVIOs për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/> (p.188/b)

pranë Zyrës për Djem dhe Burra në Shkodër, duke përcaktuar qartë në vendim vendndodhjen e zyrës si dhe ka urdhëruar përgjegjësit e zyrës të raportojnë çdo javë mbi frekuentimin e të paditurit dhunues.

Përzgjedhja e masave mbrojtëse dhe alternimi i tyre në mënyrën më të dobishme për mbrojtjen nga dhuna, është vendim tërësisht i Gjyqtarit, pavarësisht se paditësi/ja mund të kenë kërkuar konkretisht masat në padinë përkatëse. Prandaj, kur konstatoam gjatë monitorimit se gjyqtari ka dhënë në urdhrin e mbrojtjes edhe masa të tjera për të alternuar masat e kërkuara nga viktimat, menduam se, nuk jemi aspak përpara një shkeljeje të kodit të Proçedurës Civile, për shkak të shtimit të objektit të padisë. Në rastin e padisë për lëshimin e UM/UMM-së, duhet bërë mirë dallimi midis objektit të kërkesë-padisë dhe masave mbrojtëse të kërkuara. Ne mendojmë se objekti i padisë në këto raste përfshin kërkesën për UM (neni 16 i ligjit), ose për UMM (neni 18 i ligjit), ose për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes (neni 22 i ligjit). **Masat mbrojtëse të kërkuara në padi duhet të trajtohen nga gjykata si një opinion i kërkuesit dhe jo si objekt i kërkesë-padisë, me qëllim që gjyqtari i çështjes të ketë lirinë e nevojshme për të përzgjedhur e alternuar masat më efektive për mbrojtjen e viktimave, duke marrë edhe masa të tjera veç atyre të parashtruara nga kërkuesi/ja**³⁶. Kështu, në vendimet e monitoruara të GjRrGj Dibër, konstatojmë se gjyqtarët shprehin qartë në arësyetimin e vendimeve gjyqësore, rolin e gjykatës në marrjen e masave mbrojtëse efektive në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Masa e parashikuar në nenin 10, “Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje”, pika c, që lidhet me largimin e menjëhershëm nga banesa të paditësit/es për një afat kohor të caktuar rezultojnë të jetë dhënë nga GjRrGj Vlorë në 6 raste, në 16 raste në GjRrGj Pogradec dhe në 8 raste në GjRrGj Sarandë, në 8 raste në GjRrGj Elbasan. Nuk rezultojnë të jetë marrë kjo masë nga GjRrGj Dibër dhe GjRrGj Durrës.

Nga monitorimi ka rezultuar se gjykata ka shoqëruar urdhërimin e të paditurit për t’u larguar nga banesa bashkëshortore me urdhërimin e policisë së shtetit, që në mënyrë të menjëhershme dhe forcërisht të bëjë largimin nga banesa bashkëshortore të të paditurit dhe të sigurojë zbatimin e vendimit³⁷.

Masat mbrojtëse të marra nga gjykata jo gjithmonë kanë rezultuar të mirëstudiuara për të garantuar sigurinë e viktimës. Kështu rezultojnë vendime në të cilat gjykatat kanë urdhëruar të paditurin të mos shkojë dhe të mos qëndrojë në dhomën e banimit të paditëses, të ndodhur në të njëjtin apartament banimi.

Në rast se nëpërmjet kërkesës për urdhër mbrojtje kërkohet edhe mbrojtja e fëmijëve, gjykata duhet të tregojë një kujdes të veçantë në përzgjedhjen e masave mbrojtëse dhe alternimin e tyre me qëllim mbrojtjen efektive të fëmijëve nga dhuna. Kështu, në një nga vendimet objekt monitorimi në GjRrGj Vlorë, gjykata ka lëshuar Urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes vetëm për paditësen, pavarësisht se në kërkesë padi ishte kërkuar edhe mbrojtja e fëmijëve dhe ka urdhëruar dhunuesin të lejojë takimin e nënës me fëmijët, në praninë e një punonjësi policie apo punonjësi social. Pavarësisht se nuk rezultojnë rrethana dhe fakte të dhunës së ushtruar nga i padituri ndaj fëmijëve, mbetet të vlerësohet nëse është në interesin më të lartë të fëmijëve të qëndrojnë me një prind i cili është vërtetuar me vendim gjykatë se është një bashkëshort i dhunshëm.

Nga monitorimi kanë rezultuar vendime, në të cilat pavarësisht se është kërkuar nga paditësja lëshimi i UMM për vete dhe fëmijët dhe pavarësisht se rezultojnë se i padituri megjithëse punon nuk sjell të ardhura në shtëpi, është i dhunshëm ndaj bashkëshortes së tij dhe debaton me bashkëshorten në prani të fëmijëve, Gjykata ka vendosur të rrëzojë padinë për sa i përket kërkimit të paditëses për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për fëmijët.

³⁶ http://www.qag-al.org/EEB/deklarata/2010_raport%20monitorimi.pdf
<http://www.qag-al.org/EEB/deklarata/Raporti%20Monitorues%20i%20ligjit%209669.pdf>

³⁷ Vendimi i GjRrGj Shkodër.

Kjo praktikë nuk është në përputhje me rekomandimin e GREVIOs për Shqipërinë, rekomandim që nxit fuqishëm autoritetet shqiptare të rrisin ndërgjegjësimin rreth dëmit që pësojnë fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje³⁸.

Formulimi i masave nga gjykata kërkon një kujdes të veçantë. Në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, gjykata ka përfshirë në UMM edhe masën e lejitimit të paditurit të takojë fëmijën e tij pa kufizim, jashtë banesës së paditëses, në prani të punonjësve të policisë apo të shërbimeve sociale. Kjo masë, në mënyrën e formulimit duket si një masë lejuese dhe jo kufizuese. Ndërkohë që ajo përfshin dy kufizime shumë të rëndësishme së pari në lidhje me vendin e takimit dhe së dyti në lidhje me mbikqyrjen e takimit nga institucionet e përcaktuara. Por kanë rezultuar edhe praktika shumë pozitive. GjRrGj Vlorë në disa raste ka vendosur që takimi i prindit me fëmijën të kryhet nën mbikqyrjen e stafit të Qendrës Vatra³⁹.

Në një nga vendimet e monitoruara të GjRrGj Dibër, gjykata ka vendosur takimin e babait me fëmijët 1 (një) orë, në banesën e babait të tyre, takim i cili do të realizohet nën mbikqyrjen dhe shoqërimin e punonjësit të policisë. Në të njëjtën kohë gjykata ka shoqëruar këtë masë me urdhërimin e dhunuesit të mos shkojë në shkollën ku studiojnë fëmijët.

Vendimi i Gjykatës, i cili kërkon takime të mbikqyrura të fëmijës është në përputhje me rekomandimin⁴⁰ e GREVIOs i cili kërkon nga autoritetet përgjegjëse të shtetit shqiptar të sigurojnë që zbatimi i urdhrave për pasjen e kontaktit, nuk i ekspozon viktimat dhe fëmijët e tyre ndaj një rreziku të mëtejshëm.

Gjithashtu, sugjerohet përcaktimi i saktë nga gjykatat e rretheve gjyqësore në dispozitivin e vendimit për strukturën ose punonjësit që do të mbikqyrin takimin e dhunuesit me fëmijët.

Nga praktikat në GjRrGj Elbasan, ka rezultuar se në shumë vendime ku dhe fëmijët kanë qenë prezent në skena dhune, gjykata ka çmuar vetë në lidhje me fëmijët dhe nuk ka thirrur një psikolog për të vlerësuar efektet e dhunës mbi fëmijët⁴¹.

Është konstatuar një mungesë informacioni në lidhje me shërbimet ekzistuese nga organet përgjegjëse si Policia, apo OJF-të apo avokatë kur përgatisin kërkesë padinë për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes si edhe nga ana e gjykatave kur vendosin të lëshojnë urdhrat e mbrojtjes. Kështu, ndonëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë evidenton se një ndër faktorët kontribues të situatave të dhunshme në familje është varësia nga alkoli e të paditurit/ës, nuk ka marrë masa urgjente që urdhërojnë dhunuesin të ndjekë programe rehabilitimi.

Në lidhje me rehabilitimin e dhunuesve, është rritur marrja e kësaj mase nga gjykatat në UM.

Në raste të dhunuesëve me probleme të shëndetit mendor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dhënë vendime të lëshimit të UM, në të cilin ajo ka përfshirë masën e urdhërimit të të paditurit t'i nënshtrohet mjekimit të detyruar në Spitalin Psikiatrik në Vlorë.⁴²

Një tjetër tendencë është lëshimi i UMM nga gjykata për të dy palët, një prej të cilave në një çështje është paditës dhe pala tjetër në çështjen tjetër me të njëjtin objekt, është palë paditëse. Kështu GjRrGj Elbasan, me

³⁸Raporti i GREVIOs për masat legjislatve dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislatve-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje> (p.14/a)

³⁹ Vendim i GjRrGj Vlorë.

⁴⁰ Raporti i GREVIOs për masat legjislatve dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislatve-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje> (p.32/d dhe 121/d)

⁴¹ Vendimi për çështjen me palë paditëse E.C. dhe palë të paditur L.C., i GjRrGj Elbasan Vendimin për çështjen me palë paditëse L.L. dhe palë të paditur B.L., me objekt lëshimin e UMM.

⁴² Vendim i GjRrGjVlorë.

një vendim të saj ka lëshuar UMM për K.K. duke e vënë në mbrojtje nga V.K për një periudhë 6 mujore. Për të njëjtën situatë dhune, me të njëjtat palë, GjRrGj Elbasan ka lëshuar UMM për V.K. duke e vënë në mbrojtje nga K.K. për një periudhë 5 mujore, me të njëjtat masa mbrojtëse. Situata të tilla kërkojnë një kujdes të veçantë dhe marrjen e masave të qarta mbrojtëse nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, me qëllim që të mos krijohet konfuzion në lidhje me mbrojtjen nga dhuna në familje.

Praktikë pozitive në lidhje me programet e rehabilitimit të dhunesve

Në një nga vendimet objekt monitorimi, GjRrGj Shkodër 1. Ka urdhëruar të paditurin të ndjekë programin e rehabilitimit pranë shoqatës Gruaja tek Gruaja, Zyra për Burra dhe Djem, 1 herë në javë. Gjithashtu, 2. Ka urdhëruar punonjësën e shoqatës të paraqesë çdo javë informacion para GjRrGj Shkodër në lidhje me ecurinë e dhunuesit në këtë program.

GjRrGj Shkodër⁴³ ka urdhëruar akomodimin e viktimës në strehëzën e emergjencës, pranë Shoqatës Gruaja tek Gruaja Shkodër. Viktima ka qëndruar në strehëzën e emergjencës nga 48 orë deri në dy javë, deri në sistemimin e saj në Qendrën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje. Këtë masë shumë të nevojshme për sigurinë e viktimës, gjykata e ka kombinuar edhe me urdhërimin e dhunuesit të ndjekë programe rehabilitimi, pranë Zyrës për Djem dhe Burra, në Shkodër.

Edhe në vendime të dhëna nga GjRrGj Elbasan, janë urdhëruar masa të akomodimit të viktimave të dhunës në familje në strehëzën emergjente, pranë Forumit të Gruas Elbasan.

Praktikë pozitive në lidhje me bashkëpunimin e gjykatave të rretheve gjyqësore me prokuroritë

Në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Shkodër⁴⁴, gjykata ka vendosur që një kopje e vendimit të UMM-së i është dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për të verifikuar nëse janë kushtet për të filluar ndjekjen penale për të paditurin për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

Praktikë pozitive në lidhje me mbikqyrjen elektronike

Në zbatim të ligjit Nr.10494, datë 22.11.2011 “Për mbikqyrjen elektronike të personave që ju kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” dhe ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, GjRrGj Shkodër⁴⁵ ka urdhëruar policinë e shtetit dhe Zyrën kompetente të Shërbimit të Provës Shkodër, që në mënyrë të menjëhershme të mbikqyrin në mënyrë elektronike zbatimin e urdhërimit të shprehur nga gjykata, në pikën 6 të dispozitivit të këtij vendimi. Konkretisht, është urdhëruar Zyra e Shërbimit të Provës dhe Policia gjyqësore që të vendosin në trupin e paditëses, të paditurit, dhe banesës ku jeton paditësja, paisjet elektronike përkatëse që të bëjnë të mundur zbatimin efektiv të pikës 6 të dispozitivit të këtij vendimi.

2.12 ROLI I MEKANIZMIT TE REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Mbështetja dhe Shërbimet që ka marrë viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare nga institucionet dhe OJF

GjRrGj	Polici	Polici,	Gjy	Pol,gjyk,	Poli	OJF,	ZSH	NJA	Polici	Njësi	Pol	Av	Pa të
--------	--------	---------	-----	-----------	------	------	-----	-----	--------	-------	-----	----	-------

⁴³ Vendim i GjRrGj Shkodër

⁴⁴ Vendim i GjRrGj Shkodër, Vendim i GjRrGj Shkodër.

⁴⁵ Vendim i GjRrGj Shkodër. Në pikën 6 të dispozitivit është urdhëruar i paditurit F.F. të mos i afrohet paditëses P.S., fëmijëve të mitur, prindërve të paditëses, përfshirë edhe banesën e tyre, në një distance të caktuar. Vendim i GjRrGj Shkodër, etj.

	dhe gjykatë	gjykatë, qendra vatra/ SHGPS	kata	"Vatra", sh.social	ci	"Une Gruaja"	S në bashki	& OJF	dhe OJF Une Gruaja, GTG & Hapa të Lehtë, JONA	Administrative	ZSHS	okant	dhëna
Shkodër	1.12%		17.98%		66.30%				3.37%		1.12%		10.11%
Elbasan ⁴⁶													
Pogradec					7.84%	17.65%			9.80%				
Vlorë	84.14	12.41	2.07	0.69									
Dibër						25%	3.57%	3.57%	3.57%	14.29%			14.29%
Sarandë			1.92%		92.31%				1.92%			1.92%	1.92%
Durrës	98.88%	1.12%											
Korçë ⁴⁷													

Kjo është një nga tabelat më të rëndësishme të raportit. Kjo tabelë reflekton mënyrën si si procedon dhe funksionon Mekanizmi i Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në bashkitë Shkodër, Vlorë, Dibër, Sarandë, Durrës dhe Korçë.

Cfarë rezulton nga tabela:

Së pari: Organizatat e shoqërisë civile, anëtare të Rrjetit AWEN, Shoqata "Unë Gruaja", në Pogradec, Qendra Psiko Sociale "Vatra", në Vlorë, Shoqata "Jona" në Sarandë, Shoqata e Grave me Probleme Sociale në Durrës, Shoqata Gruaja tek Gruaja në Shkodër, kanë ofruar shërbime të ndryshme dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje; Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e Mekanizmave të Referimit. Forcimi i këtij roli kërkon më shumë mbështetje për organizatat e shoqërisë civile që punojnë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Së dyti, është rritur numri i institucioneve në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse që kanë ofruar mbështetje për viktimat e dhunës në familje; Kështu ka rezultuar se viktimat janë mbështetur nga policia, gjykata dhe organizatat; policia, gjykatat, organizatat dhe zyrat e shërbimeve sociale pranë bashkive, njësitë administrative dhe organizatat e shoqërisë civile etj. Numri në rritje i institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile në mbështetje të viktimave të dhunës në familje është një nga treguesit e rritjes së koordinimit të anëtarëve të Mekanizmave të Referimit në nivel vendor.

Mbështetja dhe Shërbimet që ka marrë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Elbasan

Po sjellim në mënyrë të detajuar mbështetjen dhe shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje, bazuar në monitorimin e vendimeve të GjRrGj Elbasan. Ky është një rast studimor i bashkëpunimit të institucioneve përgjegjëse dhe organizatave të shoqërisë civile në rastet e viktimave që vijnë nga bashki në të cilat nuk ka gjykata

⁴⁶ Të dhënat në lidhje me GjRrGj Elbasan po i paraqesim në mënyrë të detajuar në vijim.

⁴⁷ Të dhënat në lidhje me GjRrGj Korçë po i paraqesim në mënyrë të detajuar në vijim.

të rretheve gjyqësore. Kjo kërkon një bashkëpunim në kohë të komisariateve të policisë, bashkive përkatëse dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Mbështetja nga aktorët e MR	nr.	%
Kom.Pol.Cërrik &Gjyk.Elbasan	5	2.87
Kom.Pol.Cërrik &Gjyk.Elbasan & B.Cërrik	3	1.72
Kom.Pol.Cërrik &Gjyk&Bashkia Elbasan	2	1.15
Kom.Pol & Gjyk.Elbasan	58	33.33
Kom.Pol & Gjyk.Elbasan&B.Elbasan	37	21.26
Kom.Pol&Gj.Elbasan&B.Gramsh	1	0.57
Gj.Rr.Gj.Elbasan	1	0.57
Kom.Pol.Gramsh&Gj.Elbasan	14	8.05
Kom.Pol Gramsh &B.Gramsh&Gj.Elbasan	4	2.30
Kom.Librazhd &Gj.Elbasan	31	17.82
Kom.Librazhd,B.Librazhd &Gj.Elbasan	5	2.87
Kom.Pol.Elbasan,Gj.Elbasan &Bashkia Cerrik	1	0.57
Kom,Gjyk,Bashkia,Forumi Elbasan	6	3.45
Kom.Pol.Peqin&Gj.Elbasan	4	2.30
Kom,Gjyk,Forumi i Gruas Elbasan	1	0.57
Kom.Pol.Peqin&Bashkia Peqin&Gj.Elbasan	1	0.57

Kjo tabelë reflekton mënyrën se si procedon dhe funksionon Mekanizmi i Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në bashkinë Elbasan, sa është numri i institucioneve dhe OJF-ve të përfshira, etj.

Nga vendimet e monitoruara rezulton se në 33.33 % të vendimeve të monitoruara, ka rezultuar se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë mbështetur nga Komisarati i Policisë Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 21.26 % viktimat janë mbështetur nga Komisarati i Policisë Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Bashkia Elbasan, në 17.82 % viktimat janë mbështetur nga Komisarati i Policisë Librazhd dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në 8.05 % viktimat është mbështetur nga Komisarati i Policisë Gramsh dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me interes për monitorimin është edhe mbështetja që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë marrë nga Shoqata Forumi i Gruas Elbasan. Kështu në 3.45 % të vendimeve të monitoruara ka rezultuar se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare ka marrë shërbime dhe mbështetje nga Komisarati i Policisë Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan dhe Forumi i Gruas Elbasan. Në 0.57 % të vendimeve të monitoruara viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare është mbështetur nga Komisarati i Policisë Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Shoqata Forumi i Gruas Elbasan.

Nga monitorimi rezulton se numri i institucioneve përgjegjëse dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë ofruar mbështetje është në rritje. Nga monitorimi janë identifikuar raste të viktimave të dhunës në familje të mbështetura nga katër aktorë si Komisarati i Policisë Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan dhe Forumi i Gruas Elbasan.

Mbrojtja dhe shërbimet që ka marrë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në Korçë

Institucionet ku ka marrë shërbim viktime	Streheza e emergjencës	Zyra Kunder Dhunës dhe barazisë gjinore	Polici	pa të dhëna	zyre sociale në bashki	Total
nr.	1	1	16	62	1	81
%	1.23%	1.23%	19.75%	76.56%	1.23%	100.00%

Të tërheq vëmendjen nga tabela, mbështetja e viktimave të dhunës në familje në bashki, pranë Zyrës së Barazisë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje në bashkinë Korçë, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë Korçë, strehzës emergjente pranë kësaj bashkie dhe policisë.

2.13 PËRFAQËSIMI ME AVOKAT dhe MBËSHTETJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

GjRrGj	Po, Vatra/ OJF/ Une gruaja/ GTG/ FGE	Av.kryesisht dhe OJF	Avokat privat	pa avokat	Me përfaqësues ligjor	Av. kryesishit	Pa të dhëna
Shkodër ⁴⁸	12.3%		3.37%	93.26%	2.25%		
Elbasan ⁴⁹	9.20 %		2.30%	93.68%			
Pogradec ⁵⁰	19.6%		1.96%	1.96%			
Vlorë	11.72%		5.52%	68.28%	0.69%		14.48 %
Dibër	21.43%		17.85%			35.71 ⁵¹ %	25%
Sarandë ⁵²			3.85%	96.15%			
Durrës ⁵³			7.87%	92.13%			
Korçë			20.99%	45.68%			33.33 %

Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është i pari ligj në fushën civile që ka parashikuar detyrimin shtetëror për të siguruar përfaqësimin ligjor falas, për viktimat e dhunës. Megjithatë, nga dita e

⁴⁸ 11 viktimat nga rastet e monitoruara kanë përfituar shërbime nga Shoqata Gruaja tek Gruaja Shkodër. Rastet kanë përfituar ndihmë ligjore parësore dhe dytësore.

⁴⁹ 16 viktimat nga rastet e monitoruara kanë përfituar shërbime nga Forumi i Gruas Elbasan. Rastet kanë përfituar ndihmë ligjore parësore dhe dytësore dhe për disa prej tyre do të mbulohej shpenzimet gjyqësore.

⁵⁰ Në 10 raste nga rastet e monitoruara, viktimat janë mbështetur me shërbime të ndryshme ligjore dhe psikosociale nga Shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec.

⁵¹ Në 6 raste të përfaqësuara me avokat kryesisht, informacioni mbi këtë të drejtë ligjore është ofruar nga ARGITRA-VIZION.

⁵² Shoqata Jona, Sarandë ka përfaqësuar një viktimë të dhunës në familje në GjRrGj Sarandë dhe ka ofruar këshillime ligjore në tri raste të viktimave me UM (UMM). Gjatë vitit 2017, Shoqata “Jona” ka ofruar mbështetje psiko-sociale për të ardhur në ndihmë 15 grave, vajzave me UMM dhe familjeve të tyre. Viktimat janë mbështetur me psikologë të shoqatës edhe në komisariat dhe Gjykatë.

⁵³ Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës ka mbështetur 16 raste me ndihmë ligjore falas gjatë periudhës së monitorimit. Rastet kanë përfituar ndihmë ligjore parësore dhe dytësore.

hyrjes në fuqi e ligjit, deri më sot, nuk kemi një listë të avokatëve që do të ofrojnë këtë ndihmë. Kjo ka sjellë mungesën e përfaqësimit me avokat të viktimave gjatë procesit gjyqësor⁵⁴.

Nga monitorimi ka rezultuar se në 21.43% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Dibër, në 11.72 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë, në 4.02% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Elbasan, në 1.96% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec dhe në 1.12 % të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër viktimat është mbështetur me shërbim ligjor falas nga OJF-të.

Nga tabela rezulton që viktimat nuk janë mbështetur me shërbim ligjor, në përqindje të larta. Kështu në 96.15% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 93.68% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Elbasan, në 93.26% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Shkodër, në 92.13% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Durrës, në 68.28% të vendimeve të monitoruara në GjRrGj Vlorë dhe në 45.68% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk janë mbështetur me avokat.

Nuk rezultojnë raste të mbështetura me ndihmë ligjore falas nga avokatë të kontraktuar nga KSHNJ. Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje të mbështetura nga ky Komision vazhdon të jetë i ulët. Kështu për vitin 2017, 30 individë kanë aplikuar për Urdhër Mbrojtje dhe 19 për dhunë në familje dhe janë ndjekur nga ky Komision⁵⁵

Praktikë pozitive, GjRrGj Dibër

Në 35.71 % të vendimeve të monitoruara të GjYKATËS SË Rrethit Gjyqësor Dibër ka rezultuar se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë mbështetur me ndihmë ligjore falas nga avokatë kryesisht.

Vullneti i vetë gjykatës për të thirrur në përfaqësim avokatë nga lista e avokatëve kryesisht në procesin penal, është shumë e arsyeshme për një respektim të drejtpërdrejtë të dispozitave të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Mungesa e ndihmës ligjore falas, përbën një nga barrierat kryesore për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor efektiv për viktimat e dhunës, të cilat lihen vetëm dhe pa mbrojtje ligjore. Mbrojtja me avokat falas është e rëndësishme edhe sepse do të ndikonte ndjeshëm në uljen e rasteve të pushimit të gjykimit, në marrjen e masave efikase, si dhe në respektimin e afateve të shpejta të këtij gjykimi. Aktualisht, Organizatat jofitimprurëse, anëtare të rrjetit AWEN dhe organizata të tjera që ofrojnë shërbime ligjore falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

Ligji nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shtetit”, hyn në fuqi në datën 1 qershor, 2018 dhe kërkon miratimin e akteve nënligjore. Duke shpresuar se ky ligj do të krijojë një sistem efektiv të ndihmës juridike, ndër të tjera duke u bazuar në përfshirjen e avokatëve të trajnuar rregullisht, për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, autoritetet shqiptare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që viktimat janë informuar rregullisht për të drejtën e tyre për ndihmë ligjore si dhe të njohin, mbështesin dhe promovojnë punën e OJQ-ve të specializuara në sigurimin e ndihmës juridike për viktimat. Pritet që avokatë që kanë aplikuar në DHKA dhe janë përfshirë në listë; kanë lidhur kontratë vjetore shërbimi me DNJF; janë caktuar në ofrimin e ndihmës juridike nga organi procedues ose dhoma vendore e avokatisë; janë të

⁵⁴ http://www.qag-al.org/ËEB/deklarata/2010_raport%20monitorimi.pdf

<http://www.qag-al.org/ËEB/deklarata/Raporti%20Monitorues%20i%20ligjit%209669.pdf>

⁵⁵ MSHMS, RAPORT MASAT E MARRA NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE E DHUNËS NË FAMILJE 1 Janar – 31 Dhjetor 2017, (DRAFT)

specializuar në përfaqësimin e të miturve, viktimave, etj; do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për viktimat e dhunës në familje.

Ndihma juridike parësore do të ofrohet nga a) punonjësit me trajnim të posaçëm; b) OJF të autorizuara; dhe c) Klinika ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë;

Marrja e masave ligjore dhe të tjera nga shteti shqiptar do të ishte në përputhje me rekomandimin⁵⁶ e GREVIOs për Shqipërinë.

2.14 Referimi i vendimit të UMM/UM për ekzekutim

Nga monitorimi rezulton se gjykatat e rretheve gjyqësore referojnë vendimin e lëshimit të UMM/UM në komisariatet e policisë, Zyrate e shërbimeve sociale në bashki dhe Zyrat e Përmbarrimit për ekzekutim të vendimit. Është e një rëndësie të veçantë respektimi i afatit kohor nga gjykatat në dërgimin e kopjeve të vendimit të UMM dhe UM. Përmblotja e këtij detyrimi ligjor do të mbështeste përmblotjen e detyrimit nga përmbarruesit për të siguruar ekzekutimin efektiv të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes⁵⁷.

Tërheq vëmendjen nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Elbasan se në 38.29% të rasteve rezulton se në bazë të VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” paditësja ka përfituar ndihmë ekonomike si viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare.

2.15 Kohëzgjatja e UMM/UM

Gjykata kanë vlerësuar rrezikshmërinë me të cilën përballet viktimat e dhunës në familje, duke parashikuar kohëzgjatje të UM në përputhje me rrezikshmërinë. Tabela në vijim na jep të dhëna mbi kohëzgjatjen e urdhrave të mbrojtjes për periudhën dhe vendimet objekt monitorimi.

GjRrGj	1 vit	9 muaj	10 muaj	6 muaj	3 muaj	2 muaj	1 muaj	20 ditë	24 ditë	12-15 ditë	4 muaj	5 muaj	18 ditë	10 ditë	1 javë	8 muaj	16 ditë	pa të dhëna
Shkodër	7.87 %			3.37 %	2.25 %	1.1 2%	2.25 %	1.12		12.35 %	2.25 %	2.2 5%	3.37%	2.25%	2.25		10.1 4	56.18
Elbasan	17.3 9%			42.0 3%	4.35 %			2.90 %		8.70%			2.90%	1.45%	2.90%			
Pogradec	29.4 1%			9.80 %														60.78%
Vlorë	4.90 %		0.9 8%	3.92 %	0.98 %	2.9 4%	4.90 %	56.8 6%	0.98 %	21.57 %								1.96%
Dibër	35.7 1%	3.5 7%		3.57 %	3.57 %													53.58%
Sarandë	21.1 5%			5.77 %		9.6 2%	7.69 %	1.92 %			1.92 %							

⁵⁶ Raporti i GREVIOs për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/> (p.50/a,b,c)

⁵⁷ Raporti i GREVIOs për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>

Durrës	1.12 %		3.37 %	2.25 %	4.4 9%	13.4 8%	1.12 %		1.12%								73.03%
Korçë	6.17 %		7.40 %							2.47 %					2.47 %		81.48%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 35.71% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Dibër, në 29.41% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Pogradec, në 21.15% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Sarandë, në 17.39% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Elbasan, në 7.87% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Shkodër, në 6.17% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Korçë dhe në 4.90% të vendimeve të monitoruara të GjRrGj Vlorë, gjykatat kanë lëshuar UM për një afat 1 vit. Tabela jep të dhëna të detajuara në lidhje me kohëzgjatjen e UM dhe UMM.

Janë konstatuar vendime në të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes për një periudhë 2 muaj, ndërkohë që seanca e vërtetimit të UMM-së është caktuar brenda afatit 20 ditor të përcaktuar në ligj⁵⁸.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në kërkesat për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes dhe kohëzgjatjen e UM, referohen në situata të caktuara që gjenerojnë dhunë. Kështu në një nga vendimet objekt monitorimi të GjRrGj Vlorë, paditësja Q.H. ka kërkuar lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes me një afat të gjatë derisa të zgjidhen konfliktet e pronësisë mes palëve ndërgjyqëse.

2.16 Si është kryer denoncimi i dhunës në familje

Dhuna në familje, çështje private apo është rritur roli i komunitetit dhe aktorëve në raportim?

Kush denoncon rastet e dhunës në familje?

GjRrGj	Viktima	Komuniteti	Kryeplakja e fshatit	Institucione policia	Gjyshërit	Avokat	Pa të dhëna
Shkodër	86.52%	2.25%		1.12%	1.12%		9%
Elbasan	100%						
Pogradec	90.20%	-	-	7.84%		1.96%	
Vlorë	95.17		0.69%				4.14
Dibër	58.62%	21.43%					18%
Sarandë	100%						
Durrës	100%						
Korçë	100%						

Këto gjetje tregojnë nevojën e rritjes së raportimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare nga komuniteti. Nga ana tjetër këto gjetje reflektojnë edhe nevojën për respektimin e anonimatit të raportuesit/es së dhunës në marrëdhëniet familjare.

Praktikë pozitive në raportimin e rasteve të dhunës në familje, GjRrGj Dibër

Nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Dibër, rezulton se në 21.43% të vendimeve të monitoruara, rastet e dhunës në familje janë raportuar nga komuniteti. Këto të dhëna tregojnë për një rritje të rolit aktiv të

⁵⁸ Vendim i GjRrGjVlorë.

qytetarëve në raportimin e rasteve të dhunës në familje. Megjithatë, komuniteti mund të luajë një rol më aktiv në denoncimin e dhunës në familje në organet përkatëse.

Viktimat e dhunës në familje kanë denoncuar dhunën drejtpërdrejtë duke u paraqitur në organet e policisë ose gjykatës. Vetëm në një nga vendimet gjyqësore rezultoi se kryeplakja e fshatit ka njoftuar policinë me telefon⁵⁹.

Nga monitorimi rezultoi se kryesisht forma e raportimit ka qenë drejtpërdrejtë nëpërmjet telefonit.

2.17 TË DHËNA MBI ÇËSHTJE TË TJERA QË JANË DUKE U NDJEKUR NGA PALËT

GjRrGj	zgjidhje martese	pronësie, pjesëmarrje pasurie	penale për dhunë	Kundërshtim atësie
Shkodër	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna	
Elbasan	11.49%		0.57%	0.57%
Pogradec	17.3%		1.69%	
Vlorë	4.83	3.45	2.76	
Dibër	7.14%			
Sarandë	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna
Durrës	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna
Korçë	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna	Pa të dhëna

Nga monitorimi ka rezultuar se palët ndërgjyqëse janë në të njëjtën kohë në proces zgjidhje martese, procese gjyqësore për çështje me objekt pjesëmarrje pasurie ose çështje të tjera pronësore, për çështje me objekt kundërshtim atësie dhe çështje penale dhunë në familje.

Kreu III - Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione: Viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare është kryesisht një grua, e paarsimuar dhe e papunë, me vendlindje dhe vendbanim në qytet, me dy fëmijë, në marrëdhënie bashkëshortore me dhunuesin. Viktimat e dhunës në familje përballen me forma të ndryshme të dhunës fizike, psikologjike dhe të kombinuar dhe rezultoi një përmirësim në identifikimin e situatave të dhunës, formave të saj, faktorëve kontribues të cilat përbëjnë një premisë të mirë për dhënien e një vendimi të drejtë. Rezultoi se fëmijët dhe pjestarë të tjerë të familjes janë persona të tretë të dëmtuar nga dhuna e ushtruar në marrëdhëniet familjare.

Sugjerime: Ky profil kërkon nga aktorët në nivel lokal marrjen e masave me qëllim fuqizimin e grave përmes programeve të punësimit, ofrimit të shërbimeve falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, rritjes së garancive për mbrojtjen e fëmijëve të mitur nga dhuna në familje. Analiza e faktorëve kontribues në dhunën në familje si varësia nga alkoli, mosmarrëveshje në lidhje me çështje pronësore, xhelozia, papunësia dhe probleme ekonomike, grindjet dhe mosmarrëveshjet, natyra e dhunshme dhe çrregullime psikologjike, mosmarrëveshje në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kujdestarinë e fëmijëve, probleme që lidhen me zgjidhjen e martesës ose ndërprerjen e bashkëjetesës, probleme të shëndetit mendor të dhunuesit, varësia nga lëndë narkotike, tradhëtia bashkëshortore, varësia nga lojërat e fatit, denoncimi i dhunës në familje dhe ndjekja penale, jep një mesazh të qartë mbi nevojën e ngritjes së programeve të rehabilitimit për dhunuesit të cilat do të kontribuonin jo vetëm për mospërsëritjen e rasteve të

⁵⁹ Vendim i GjRrGj Vlorë.

dhunës në familje, por edhe për rritjen e sigurisë së viktimave. Rekomandohen politika dhe shërbime efektive për personat me probleme të përdorimit të drogës dhe alkolit si dhe personat me probleme të shëndetit mendor. Trajtimi i kujdesshëm i këtyre personave dhe marrja e masave për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, kur ajo ushtrohet nga persona me probleme të shëndetit mendor janë nevojë imediate. Inkurajohen studime mbi koston e dhunës në familje në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë, kur ajo kryhet nga persona që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, varësia nga drogat, alkoli dhe lojërat e fatit.

Konkluzione: Ndonëse ka një përmirësim të qartë në respektimin e afateve të gjykimit të kërkesave për lëshimin e UMM/UM, ende shtyhen në mënyrë të panevojshme seancat gjyqësore për vërtetimin e UMM dhe lëshimin e UM.

Sugjerime: Të forcohet roli i KLD për t'i vënë para përgjegjësisë gjyqtarët që nuk respektojnë afatet ligjore. Shpejtësia dhe respektimi i afateve, përbën një element thelbësor të gjykimit për urdhrat e mbrojtjes, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e kuptimit të ligjit kundër dhunës në familje dhe mund të vërë në rrezik viktimat. Analizat e KLD mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe performancën e gjyqtarëve në zbatim të këtij ligji sugjerohet të jenë të vazhdueshme.

Konkluzion: Pavarësisht disa modeleve të krijuar në lidhje me padinë publike në komisariate të ndryshme policie, nuk na ka rezultuar gjatë monitorimit të jetë përdorur ky institut për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, në rrezik të lartë dhe sidomos viktimave të mitur të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sugjerime: Një vëmendje e veçantë ka nevojë t'i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në familje. Gjyqtarët mund të përfshijnë në urdhrin e mbrojtjes edhe fëmijët që kanë pësuar dhunë të asistuar. Lind nevoja të forcohet roli aktiv i gjykatës përmes marrjes së masave mbrojtëse ex officio, padia publike si edhe kërkesat për urdhër mbrojtjeje për fëmijën, në rastet e ushtrimit të dhunës së drejtpërdrejtë nga cilido anëtar i familjes ose dhunës së asistuar. Për këtë mendojmë se krijon mundësi më të mëdha Ligji nr.10329, datë 30.09.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, i cili parashikon se, policia dhe prokuroria janë subjekte që legjitimohen të paraqesin urdhër mbrojtjeje për të mitur. Këtij aspekti pritet t'i kushtojë një vëmendje edhe projektligji që po përgatitet mbi shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Konkluzione: Nga monitorimi janë identifikuar disa praktika pozitive. Disa prej tyre janë referimi në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, respektimi i afateve ligjore, zgjerimi i aktorëve ku viktimat e dhunës në familje denoncon dhunën, zgjerimi i rrethit të aktorëve që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, respektimi i afateve ligjore, larmishmëria e masave mbrojtëse dhe një kombinim i kujdesshëm i tyre, mbështetja e viktimave të dhunës në familje me ndihmë ligjore nga avokatë kryesisht, etj.

Sugjerime: Sugjerohet që praktikatat pozitive të identifikuar në kuadrin e këtij monitorimi të bëhen publike edhe nëpërmjet mediave, duke përfshirë mediat sociale me qëllim replikimin e tyre në sa më shumë gjykata dhe bashki.

Konkluzion: Konstatojmë se masat mbrojtëse të kërkuara në padi janë trajtuar nga gjykata si një opinion i kërkuar dhe jo si objekt i kërkesëpadisë, me qëllim që gjyqtari i çështjes të ketë lirinë e nevojshme për të përzgjedhur masat më efektive për mbrojtjen e viktimave. Nga monitorimi ka rezultuar një larmishmëri masash mbrojtëse të cilin gjykatat e kanë përdorur në mënyrë creative, me qëllim sigurimin e një mbrojtje sa më efektive për viktimat e dhunës në familje.

Sugjerim: Sugjerojmë që ky konstatim të ndahet si një praktikë pozitive me të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore të monitoruara;

Konkluzione: Konstatojmë se në përqindjen më të lartë të rasteve gjykatat kanë vlerësuar se, çështja e provueshmërisë së pretendimeve në gjykimet me objekt “Lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes” paraqet disa veçori në dallim nga gjykimet e mosmarrëveshjeve të tjera.

Eshtë konstatuar se kur gjykatat e rretheve gjyqësore nuk kanë disponuar të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të nenit 15 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, kanë lëshuar me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Sugjerim: Gjykatat e Rretheve Gjyqësore mund të lëshojnë urdhrin e mbrojtjes edhe bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet, të krijuar nga shpjegimet e palëve në gjykim (neni 15/3 i Ligjit).

Konkluzion: Konstatojmë praktika pozitive në GjRrGj Dibër, në lidhje me vendimin e gjyqtarit civil për të vendosur përfaqësimin e viktimave të dhunës gjatë procesit gjyqësor për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, nga avokatë kryesisht, falas. Kjo praktikë përbën një zbatim efikas të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Sugjerime: Sugjerohet miratimi i shpejtë i akteve nënligjore të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe zbatimi i ligjit, me qëllim garantimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Konkluzione: Konstatohet një rritje e numrit të vendimeve gjyqësore në të cilat parashikohet që e drejta e takimit të prindit me fëmijët të kryhet e mbikqyrur nga psikologë ose punonjës të policisë ose specialistë të tjerë, me qëllim sigurinë e viktimave madhorë dhe të mitur. Masa e largimit të dhunuesit/es nga banesa bashkëshortore nuk ka rezultuar në të gjitha gjykatat objekt monitorimi.

Sugjerim: Sugjerohet që kjo praktikë të forcohet me qëllim rritjen e sigurisë së viktimave të dhunës në familje të cilat shpesh përballen me forma ekstreme të dhunës në familje gjatë ushtrimit të të drejtës së takimit të fëmijës nga njëri prind. Rekomandohet që në rastet kur prindi dhunues ka të drejtën e takimit, vizitës, vendimi të shoqërohet me një plan sigurie që do të ofronte mbrojtje për viktimën dhe fëmijët dhe nuk do t'i përballte ato me një dhunë edhe më ekstreme. Sugjerohet marrja e masës së parashikuar në nenin 10, pika c e ligjit kundër dhunës në familje, si një masë që rrit sigurinë e viktimave të dhunës në familje.

Konkluzion: Janë shënuar hapa shumë pozitivë në respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin e UMM dhe UM.

Sugjerim: Rekomandohet analiza e shkaqeve të mos respektimit të afateve ligjore në praktikën gjyqësore dhe vënia para përgjegjësisë e gjyqtarëve përgjegjës në rastet kur konstatohet se kanë shkelur afatet ligjore pa shkaqe të arsyeshme.

Konkluzion: Nuk rezulton bashkëpunimi i duhur ndërinstitutional mes gjykatave të rretheve gjyqësore objekt monitorimi dhe dhomave vendore të Avokatisë me qëllim caktimin e listës së avokatëve për ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e dhunës në familje.

Sugjerim: Sugjerohet të forcohet bashkëpunimi ndërinstitutional i gjykatave të rretheve gjyqësore me dhomat vendore të avokatisë, me qëllim caktimin e listave të veçanta me avokatë të posaçëm për ofrimin e ndihmës për viktimat e dhunës në familje.

Konkluzion: Një praktikë pozitive është konstatuar në GjRrGj Shkodër, në të cilën është vendosur urdhërimi i dhunuesit të ndjekë programin e rehabilitimit pranë Shoqatës Gruaja tek Gruaja, Zyra për Djem dhe Burra, Shkodër dhe është ngarkuar punonjësi i kësaj organizate të informojë GjRrGj Shkodër mbi ecurinë e dhunuesit në programin e rehabilitimit. Kjo është një praktikë e rëndësishme sepse bën të zbatueshme masën m, të nenit 10 “Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje”, të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare të ndryshuar” dhe i jep mundësi gjykatës që nëse dhunuesi nuk e ndjek programin e rehabilitimit, gjykata të zbatojë dispozitat e Kodit Penal për pengimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës për lëshimin e UMM/UM.

Sugjerim: Me qëllim përmirësimit e punës në gjykatat e rretheve gjyqësore, sugjerohet që organizatat që kanë kryer monitorimin të organizojnë aktivitete në të cilat të ndajnë praktikatat më të mira si edhe praktikatat që ka nevojë të përmirësohen. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e praktikave të punës në gjykata dhe institucione të tjera përgjegjëse në nivel vendor.

Konkluzion: Rezulton një rritje e numrit të aktorëve që kanë mbështetur viktimat e dhunës në familje. Policia, gjykatat, organizatat e shoqërisë civile anëtare të AWEN në rrethet objekt monitorimi, Zyrat e Shërbimeve Sociale në bashki, Njësitë administrative janë ndër aktorët më aktivë që rezultojnë të kenë mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe t’i kenë dhënë dinamizëm dhe efektivitet punës së Mekanizmit të Referimit.

Sugjerim: Sugjerohet zgjerimi i institucioneve përgjegjëse aktive në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbështetjen e rasteve; Ngritja e MR në të gjitha bashkitë e vendit është një prioritet i përcaktuar nga GREVIO dhe shumë organizata të tjera. Roli i OJF-ve, në mënyrë të veçantë organizatave anëtare të AWEN në punën e mekanizmit është shumë i rëndësishëm. Sugjerohet vëmendja e shtetit dhe donatorëve/partnerë për një financim të qëndrueshëm për OJQ-të e grave që punojnë për të mbështetur viktimat dhe parandaluar dhunën, dhe kështu duke i bërë ato të afta për të përmbushur plotësisht nevojat e të gjitha viktimave (paragrafi 32)⁶⁰.

Edhe ngritja e OJF-ve të reja në nivel lokal do të kontribuonte në rritjen e efektivitetit të punës së këtij mekanizmi.

Konkluzion: Nga monitorimi I vendimeve gjyqësore ka rezultuar se Zyrat e Shërbimeve Sociale pranë bashkive të ndryshme, kanë mbështetur viktimat për të përfituar ndihmën ekonomike gjatë kohës që UM është në fuqi.

Sugjerim: Duke qenë se ende mbetet për të bërë, me qëllim informimin e viktimave dhe komunitetit në tërësi, sugjerohet që viktimat e dhunës në familje të mund të përfitojnë ndihmën ekonomike, që nga momenti i lëshimit të urdhrave të mbrojtjes nga gjykata dhe për kohën që urdhrat e mbrojtjes janë të vlefshëm.

Konkluzion: Aksesit në drejtësi i viktimave të dhunës në familje ka nevojë të forcohet. Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje që janë mbështetur me ndihmë ligjore falas vazhdon të jetë i kufizuar.

Sugjerim: Sugjerohet të rriten përpjekjet për zbatimin e ligjit nr.111/2017, nxjerrjen e akteve nënligjore, njohja dhe organizimi i trajnimeve në lidhje me këtë ligj të ri, etj.

Konkluzion: Rezulton një tendencë në rritje e referimit të gjykatave shqiptare në standardet ndërkombëtare të Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit. Kështu ka rezultuar referim në Konventën e Stambollit

⁶⁰Raporti i GREVIOs për masat legjislatve dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislatve-dhe-te-tjera-ge-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje>

në vendimet e GjRrGj Shkodër dhe GjRrGj Durrës, etj. Nuk ka rezultuar nga monitorimi referim në Konventën e Stambollit nga GjRrGj Elbasan dhe GjRrGj Vlorë.

Sugjerohet përfshirja e këtij treguesi në skedën vlerësuese sepse këto standarde mund të përdoren si një mjet i fortë për arritjen e barazisë gjinore dhe luftën kundër DHBGJ. Gjithashtu sugjerohet të rritet përdorimi nga gjykatat e rretheve gjyqësore i standardeve ndërkombëtare të Konventës së Stambollit, Konventës CEDAW dhe UPR.

Konkluzion: Nga monitorimet rezulton një nevojë e fortë për rritjen e numrit të trajnimeve për profesionistët, përgjegjës në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje si gjykatat, policia, avokatët, etj., me qëllim njohjen më të mirë të standardeve ndërkombëtare dhe rritjen e aftësive të tyre për t'i bërë këto standarde pjesë të vendimmarrjes.

Sugjerim: Sugjerohet organizimi i trajnimeve me Shkollën e Magjistraturës për gjyqtarë dhe prokurorë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve mbi rolin që mund të luajnë këto standarde në litigim dhe litigim strategjik. Edhe Shkolla e Avokatisë duhet të bëjë pjesë të kurrikulës së saj standardet e Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit, duke vënë theksin në përdorimin e standardeve në mënyrë konkrete. Është e nevojshme që Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare dhe dhomat vendore të Avokatisë të forcojnë bashkëpunimin.

Bibliografia

Konventa të ratifikuara nga shteti shqiptar

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104/2012.

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW, ligji nr.1769, datë 9.11.1993.

Ligje:

1. Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
2. Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
3. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Raporte:

1. Raporti i GREVIOs për masat legislative dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
<https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>
2. MSHMS, RAPORT MASAT E MARRA NË LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE E DHUNËS NË FAMILJE 1 Janar – 31 Dhjetor 2017, (DRAFT paraqitur në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, 2018)
3. <http://AWENetwork.org/wp-content/uploads/2017/01/Raporti-i-integruar-09-korrik-2015-AWEN.pdf>
4. <http://AWENetwork.org/wp-content/uploads/2017/01/Raporti-i-integruar-Monitorimi-i-UM-UMM-ve-ne-7-rrethe-Janar-Tetor-2013.pdf>
5. Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, (periudha e monitorimit: 01.06.2007-31.04.2008, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2008.
<http://www.qag-al.org/WEB/deklarata/Raporti%20Monitorues%20i%20ligjit%209669.pdf>
6. Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2009. (botuar në ëbsite: <http://www.qag-al.org>). http://www.qag-al.org/WEB/deklarata/2010_raport%20_monitorimi.pdf
7. <http://www.kld.al/component/k2/raport-mbi-situaten-e-ceshtjeve-gjyqesore-per-dhunen-ne-familje>